

RAPORT VJETOR

PËR VITIN 2018

KOMITETI I
**HELSEINKIT**
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKES SË
MAQEDONSË



RAPORT VJETOR

për vitin 2018

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2018 I KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga
kryetari i KD-së Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktore:

Uranija Pirovska

Përktheu:

Shenasi Jaji

Dizajni grafik dhe shtypi:

Relativ



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
SISTEMI GJYQËSOR.....	9
PROCESE NË GJEDNJ.....	24
TRAJTIMI I BARABARTË.....	27
GJUHA E URREJTJES.....	33
VEPRA NGA URREJTJA.....	36
INSTITUCIONE TË MBYLLURA.....	40
GRUPET E RREZIKUARA.....	48
TË DREJTAT E PUNËTORËVE.....	51
GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT.....	55
BARAZIA GJINORE.....	58
MIGRANTËT, REFUGJATËT DHE AZILKËRKUESIT.....	64
NDIHMJA JURIDIKE FALAS.....	74
QENDRA PËR MBËSHTETJE LGBTI.....	79
REKOMANDIME.....	85
SHTOJCA 1.....	95

HYRJE

Përkundër disa zhvillimeve pozitive, viti 2018 ishte një tjetër vit në të cilin ngjarjet politike mbizotëruan proceset e reformës. Referendumi i dështuar, i cili vijoi pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës dhe përpjekjet për të krijuar një shumicë parlamentare për miratimin e saj në Kuvend, rezultoi me Ligjin e diskutueshëm për amnistinë e pjesëmarrësve në ngjarjet e “Të enjtes së përgjakshme”. Ndërhyrja e politikës në sistemin gjyqësor ka shkelur parimet e barazisë para ligjit dhe sundimit të ligjit. Institucionet gjithashtu dështuan edhe në rastin e arratisjes së ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, ku për këtë rast nuk kishte asnjë përgjegjësi të autoriteteve kompetente.

Këto ngjarje, së bashku me miratimin jo-transparent të disa ligjeve në fushën juridiko-penale, hedhin një hije mbi bashkëpunimin e vendosur midis Qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Megjithëse përfshirja e tyre në miratimin e ligjeve të caktuara ishte në një nivel të kënaqshëm, dhe Grupi Blueprint për sistemin gjyqësor ka marrë pjesë aktivisht në procesin e përgjithshëm të reformës, megjithatë ndërhyrjet e pjesshme dhe të motivuara politikisht në ligje të rëndësishme ulën sigurinë ligjore të qytetarëve dhe dëmtojnë qëllimet e tyre të reformës. Statusi i Prokurorisë Speciale Publike është gjithashtu në fushën e kalkulimeve partiake, megjithëse shtyrja e zgjidhjeve ligjore mund të rrezikojë procedurat tashmë të hapura. Është e pashmangshme e të mos përmenden edhe negociatat partiake rreth Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, miratimi i të cilit u vonua për muaj dhe u shoqërua me "spin"-e mediatike dhe deklarata të diskutueshme nga zyrtarë të lartë politikë. Atmosfera e përgjithshme në vend gjatë periudhës raportuese intensifikoi gjuhën e urrejtjes në hapësirën mediatike, dhe akoma më shqetësuese është dyfishimi i numrit të veprave të regjistruara të urrejtjes, krahasuar me vitin e kaluar. Megjithëse veprat e tilla janë kryesisht në baza etnike, shpërthimet e urrejtjes kundër komunitetit LGBTI, migrantëve, grave etj., janë gjithashtu të pranishme. Policia, gjykatat dhe Prokuroria Publike kanë mbetur injorante dhe joefektive në zgjidhjen e rasteve të tilla. Ndërgjegjësimi është gjithashtu një hallkë që mungon në rastet e dhunës me bazë gjinore, ku autoritetet shpesh dështojnë të trajtojnë viktimat dhe t'i mbrojnë ato.

Përveç rishikimeve specifike të situatës me barazinë gjinore, gjuhën dhe veprat e urrejtjes, diskriminimin dhe të drejtat e njeriut të grupeve të cënueshme dhe komunitetin LGBTI, raporti gjithashtu e shqyrton edhe situatën e të drejtave të punëtorëve, me një theks të veçantë të të drejtave të grave punëtore në industrinë e tekstilit. Ky raport gjithashtu përfshin disa procese specifike gjyqësore që janë pjesë e monitorimit të rregullt gjyqësor të Komitetit gjatë vitit 2018, dhe ne gjithashtu i referohemi edhe situatës me institucionet e mbyllura në vend. Duke qenë se Komiteti i Helsinkit është i njohur sa i përket sigurimit të ndihmës juridike falas për qytetarët dhe i etiketon të gjitha mospërputhjet në ligjin ekzistues në raport, ne i përfshijmë edhe komentet mbi projektligjin e ri për NJF. Përveç situatave dhe zhvillimeve të identifikuara gjatë vitit 2018, ky raport përmban gjithashtu edhe rekomandime të përshtatshme për të gjitha fushat në të cilat vepron Komiteti. Me to japim kahje të qarta për trajtimin e pikave dhe fenomeneve problematike që e formësojnë situatën e përgjithshme me të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe presim që vendimmarrësit t'i marrin në konsideratë gjatë krijimit të masave dhe politikave shtetërore.



SISTEMI GJYQËSOR

REFORMAT NË SISTEMIN GJYQËSOR

Zbatimi i reformave në sistemin gjyqësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një nga kushtet thelbësore për integrim në Bashkimin Evropian, duke pasur parasysh se Kapitulli 23 është kapitulli më i rëndësishëm në procesin e anëtarësimin në Bashkim. Komisioni Evropian në Raportin për vendin tonë për vitin 2018 (publikuar në muajin prill 2018), i cili mbulon periudhën tetor 2016 - prill 2018, rekomandoi që gjatë vitit 2018 të miratohen dhe zbatohen masat e parashikuara në Strategjinë për reforma në sistemin gjyqësor 2017-2022 dhe Planin e veprimit për zbatimin e saj, përfshirë reformat e sistemeve për emërimin, ngritjen në detyrë, disiplinën dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të demonstrohet se pavarësia e gjyqësorit respektohet dhe promovohet në të gjitha nivelet. Në vazhdim të këtij raporti, KE deklaroi se, përkundër një progresi të dukshëm, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar plotësisht strategjinë dhe implementimin e rekomandimeve të mbetura, në mënyrë që gjyqësori të funksionojë i lirë nga ndikimi i panevojshëm nga jashtë dhe brenda. Raporti vuri në dukje se mbetet rreziku i ndërhyrjes politike në gjyqësor, praktika e drejtësisë selektive në raste të caktuara të ndjeshme politikisht dhe u theksua se, përkundër faktit se të drejtat themelore janë kryesisht të garantuara nga ligji, zbatimi do të kërkojë angazhim të vazhdueshëm për reformën. Sidoqoftë, viti 2018 kaloi me një theks në zgjidhjen e çështjeve politike të tilla si rregullimi i përdorimit të gjuhëve të bashkësive të tjera dhe mosmarrëveshja me Greqinë për emrin e vendit tonë (miratimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, më pas nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës, organizimi dhe zhvillimi i Referendumit 2018, “ndjekja” e një shumice prej dy të tretave pas referendumit të dështuar, miratimi i Ligjit për amnisti për ngjarjet e 27 prillit, votimi i ndryshimeve kushtetuese, etj.), në vend që të zbatoheshin reformat e nevojshme gjyqësore.

Sipas Strategjisë për reformat në sistemin gjyqësor, të miratuar në nëntor të vitit 2017 dhe Planit të saj të veprimit, zbatimi i masave dhe aktiviteteve për zbatimin e këtyre reformave duhet të ishte realizuar më së voni deri në dhjetor të vitit 2018. Sidoqoftë, për shkak të të gjithë aktiviteteve të mësipërme politike, për fat të keq, rrjedha e këtyre reformave nuk shkoi sipas planit fillestar 3-6-9, i përkthyer më vonë në Strategjinë për reforma 2017-2022 dhe Planin e veprimit dhe i gjithë procesi dukej sikur të ishte i ngrirë. Komiteti i Helsinkit, së bashku me organizatat partnere të Grupit Blue Print, monitoruan nga afër të gjithë procesin e zbatimit dhe implementimit të reformave gjyqësore strategjike, veçanërisht në aspekt të respektimit të kornizës kohore të parashikuar për zbatimin e reformave, përfshirjen e shoqërisë civile, palëve me interes, publikut dhe transparencës së tërë procesit.

Konkluzioni i përgjithshëm që mund të nxirret rreth tërë procesit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara me Strategjinë për reforma në sistemin gjyqësor, është se i gjithë procesi u vonua ndjeshëm dhe se për segmente të caktuara nuk kishte përfshirje të mjaftueshme të organizatave të shoqërisë civile, nga e cila mund të konkludohet se i gjithë procesi i reformës ishte pjesërisht transparent. Gjegjësisht, shumica e afateve kohore të parashikuara për zbatimin dhe përmbushjen e aktiviteteve dhe masave të parashikuara me Planin e veprimit nuk ishin respektuar. Për këto arsye, në qershor të vitit 2018, Qeveria përgatiti një projekt-plan 18 i cili në fakt vetëm i zgjati afatet e përcaktuara më parë me Planin e veprimit për zbatimin e Strategjisë 2017-2022. Organizatat e shoqërisë civile nga Grupi Blue Print reagues se ky plan nuk ishte mjaft i qartë dhe se po përqendrohej vetëm në zgjatjen e afateve për zbatimin e reformave. Ky plan shtyu afatet për miratimin e disa ligjeve strategjike për vitin e ardhshëm, respektivisht vitin 2019. Përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile nuk u përfshinë fare në grupet e punës që mbulojnë reformën në fushën juridiko-penale, megjithëse përfaqësuesit e opinionit profesional dhe palët e interesit (profesorë, gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë) ishin të përfshirë. Ekspertiza e organizatave të shoqërisë civile nga përvoja e gjatë në këtë fushë është sigurisht e një rëndësie të madhe dhe mund të kontribuojë në krijimin e zgjidhjeve të përmirësuara ligjore që do të promovojnë dhe mbrojnë në mënyrë adekuate të drejtat e qytetarëve në këtë fushë ligjore. Nga rekomandimet e dhëna në Raportin e KE për vitin 2017 në fushën e gjyqësorit, rezulton se ka nevojë për përfshirje më të madhe dhe rritje të ndikimit të organizatave të shoqërisë civile në procesin e zbatimit të Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor dhe në procesin e implementimit të saj. Organizatat e shoqërisë civile, përfshi Komitetin e Helsinkit, megjithëse kishin njohuri dhe përvojë përkatëse në fusha të caktuara, nuk ishin të përfshirë drejtpërdrejt në grupet e punës dhe aktivitete të tjera për miratimin e ligjeve të caktuara dhe akteve të tjera. Konkretisht, përfaqësuesit e sektorit të shoqërisë civile nuk ishin të ftuar fare në grupet e punës që punojnë në ndryshimet në Ligjin për Procedurën Penale, Kodin Penal dhe Ligjin për Prokurorinë Publike.

Nga ana tjetër, përfshirja dhe ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në miratimin e ligjeve të caktuara ishte në një nivel të kënaqshëm. Kështu, në procesin e ndryshimit dhe miratimit të ligjeve për gjykatat, Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile morën pjesë në mënyrë të barabartë në grupet e punës, ishin të ftuar në takime me përfaqësuesit e Komisionit të Venecias, dhe disa nga rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile u pranuan si një zgjidhje ligjore. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu u përfshinë në grupet e punës për miratimin e një ligji të ri për kundërvajtje dhe ndryshime në Ligjin për

kontestet administrative, dhe Ligji për ndihmë juridike falas, pas komenteve dhe reagimeve nga organizatat e shoqërisë civile, u tërhoq dhe u kthye në fillim të procesit të miratimit.

Lidhur me transparencën e procesit të zbatimit të reformave gjyqësore, Komiteti i Helsinkit e vlerëson atë si pjesërisht transparente. Gjegjësisht, përkundër faktit se Qeveria dhe institucionet që punojnë në zbatimin e reformave bëjnë përpjekje për përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile dhe publikut në procesin e zbatimit të këtyre reformave, në realitet ndodhi që ligje sistemore, siç është Ligji për Procedurën Penale dhe veçanërisht Kodi Penal, të ndryshohen dhe plotësohen pa një dëgjim publik gjithëpërfshirës, e për disa nga këto ndryshime madje dhe pa i botuar menjëherë në ENER për komente. Grupi i punës punoi intensivisht në ndryshimet e mëdha të reformës në Ligjin për Procedurën Penale, por në fund të tetorit të vitit 2018, pa diskutime paraprake dhe debate publike, u botua një projektligj për ndryshimin e Ligjit për Procedurën Penale, ku u intervenua vetëm në dispozitat për përcaktimin e masave PI dhe pjesërisht në dispozitat që e rregullojnë masën e paraburgimit. Më 31 dhjetor, kjo ndodhi edhe me Kodin Penal, i cili prezantoi ndryshime që mund të shkelnin seriozisht politikën penale të krimeve financiare. Përveç këtyre ndryshimeve fatkeqe në Kodin Penal, u miratuan edhe ndryshime dhe plotësime pozitive, në dispozitat e përgjithshme që përcaktojnë qartë se çfarë nënkuptohet me vepër nga urrejtja, si bazë për kryerjen e veprave nga urrejtja u zgjerua ku u përfshinë edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor, kurse për veprat e veçanta penale u fut një kualifikim më i rëndë nëse një vepër kryhet nga urrejtja. Gjithashtu, ndryshimet dhe plotësimet përmirësuan mbrojtjen juridiko-penale dhe u përfshi një vepër e re “pengimi i drejtësisë”, si dhe dispozitat në lidhje me dëshmitarët e mbrojtur, do të kontribuojnë në një mbrojtje më efektive juridiko-penale në vend. Megjithëse procesi i përgatitjes së Strategjisë dhe Planit të veprimtimit 2017-2022 ishte veçanërisht gjithëpërfshirës, në fakt zbatimi i strategjisë nuk është mjaft transparent, madje as gjithëpërfshirës.

KËSHILLI PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR REFORMA NË SISTEMIN GJYQËSOR 2017-2022

Komiteti i Helsinkit, së bashku me anëtarët e tjerë të Grupit Blue Print për gjyqësorin, morën pjesë me përfaqësuesin e tij në punën e Këshillit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor. Komiteti vlerëson

pjesëmarrjen dhe punën në këtë këshill si një shembull pozitiv, sepse përmes tij organizatat e shoqërisë civile patën mundësinë të paraqesin drejtpërdrejt pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre mbi reformat në sistemin gjyqësor tek vendimmarrësit, si dhe të bëjnë drejtpërdrejt propozime, të cilat në disa rastet edhe u pranuan. Në këtë mënyrë, anëtarët e Grupit Blue Print për gjyqësorin ishin aktorë aktivë në procesin e përgjithshëm të reformës.

(PA)VARËSIA DHE (PA)ANSHMËRIA E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË PROKURORËVE PUBLIKË

Gjatë vitit 2018, përveç zgjedhjes së dy gjyqtarëve kushtetues në vend të dy gjyqtareve kushtetuese, mandati i të cilave kishte mbaruar, nuk u bë asnjë zgjedhje e gjyqtarëve të tjerë, por u shpallën konkurse për zgjedhjen e gjyqtarëve në disa instanca. Mirëpo, si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2018 kishte vetëm një zvogëlim të numrit të gjyqtarëve për shkak të pensionimit ose shkarkimit. Për shkak të skadimit të mandatit të atyre të mëparshmeve, u zgjodhën 6 (gjashtë) anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor të RMV-së. Përzgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë bëhet ende në përputhje me Ligjin aktual për Gjykatat, Ligjin për Prokurorinë Publike dhe Ligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ligjet e reja, të hartuara nga përfaqësuesit e sektorit të shoqërisë civile, pritet të përmirësojnë mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjyqtarëve, në mënyrë që të hyjnë juristë profesionistë të gjyqësorit me integritet të ndërtuar, jopartiak dhe jo të politizuar dhe për të shmangur mënyrën aktuale të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga “fletoret e partisë”. Sepse, sipas të gjitha rekomandimeve që kemi marrë nga bashkësia ndërkombëtare deri më tani, çelësi për çlirimin përfundimtar të “shtetit të kapur” nuk është vetëm heqja e të ashtuquajturit regjimi por edhe ndërtimi i një sundimi të ligjit në të cilin, në vend të pushtetit partiak, sundimi i ligjit do të mbizotërojë dhe ligjet dhe të drejtat e njeriut do të respektohen, diçka që nuk është e mundur pa një gjyqësor të pavarur, objektiv dhe jopartiak.

Një risi e rëndësishme, e cila do të kontribuojë në reformimin e sistemit gjyqësor dhe forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, është miratimi i Ligjit për shfuqizimin e Ligjit për Këshillin për konstatimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së një gjyqtari. Ky ligj shfuqizoi Këshillin për konstatimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së një gjyqtari, që ishte

krijuar në vitin 2015, me detyrë për të vepruar ndaj ankesave dhe kundërshtive kundër gjyqtarëve. Ishte një organ i veçantë hetimor për të ndarë fazat e posaçme në procedurën për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit (ngritja e procedurës, mbarëvajtja e hetimit dhe vendimi për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit). Që nga fillimi, nga ana e publikut profesional kjo ishte vlerësuar si një hap i panevojshëm dhe kjo u konstatua edhe gjatë punës së tij te deritanishme. Me abrogimin e Këshillit, u mundësua kthimi i kompetencave të Këshillit Gjyqësor për mbarëvajtjen e procedurës disiplinore. Sipas ndyshimeve në pjesën për ngritjen e procedurave kundër gjyqtarëve të caktuar nga ana e Këshillit Gjyqësor do të synohet që anëtarët e Këshillit Gjyqësor që kanë inicuar procedura si „prokurorë“ të mos përfshihen në marrjen e vendimit si „gjyqtarë“. Kjo zgjidhje është në vijë të drejtë me qëndrimet e Komisionit të Venecias dhe praktikave të etabluara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Paketa e ligjeve për reforma në shërbimin prokurorial deri në fund të periudhës së raportimit akoma ishte në versionin e saj të punës, megjithëse përmes saj duhet të zgjidhet edhe statusi i PSP-së. Megjithëse shumë çështje të rëndësishme mbeten të pazgjidhura sa i përket këtij legjislacioni, në muajin tetor të vitit 2018, në një mënyrë mjaft jotransparente u bë një ndryshim i pjesshëm i Ligjit për Prokurorinë Publike dhe u miratua Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë Publike. Me këto ndryshime Prokuroria Publike futet në sistemin e kontrollit të jashtëm të policisë, një zgjidhje që pritet një kontroll mbi një segment të rëndësishëm do të përmirësohet dhe avancohet. Megjithatë, Komiteti konsideron se një mënyrë e tillë e miratimit të ligjeve të rëndësishme sistemore dhe zgjidhjes së segmentuar të problemeve, do të kontribuojë në uljen e sigurisë juridike të qytetarëve dhe në uljen e parimit të sundimit të ligjit.

SISTEMI AKMIS

Në vitin 2018, Ministria e Drejtësisë në opinion e publikoi Raportin për sistemin AKMIS, që ishte rezultat i kontrolleve të kryera mbi punën e shërbimeve të këtij sistemi për shpërndarjen dhe udhëheqjen e lëndëve gjyqësore. Subjekt i këtij kontrolli ishin tri gjykata: Gjykata Themelore Shkup 1 – Shkup, Gjykata e Apelit në Shkup dhe Gjykata Supreme e RMV-së. Në këtë raport konkludohet se gjykatat nuk e respektojnë si duhet Ligjin për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata dhe Rregullores së Gjyqeve, AKMIS nuk përdoret plotësisht në përputhje me de-

dikimin e tij, keqpërdoren dispozitat e akteve ligjore për ndyshime të shpeshta të orareve vjetore të gjykatave dhe nuk respektohen dispozitat për specializimin e gjyqtarëve sipas sferave. Me një ndyshim të tillë dhe të shpeshtë të orarit vjetor, madje në disa gjykata duke i shpërndarë lëndët me dorë te gjyqtarë të caktuar, e keqpërdorin sistemin AKMIS dhe shpërndarjen automatike të lëndëve, është ndikuar edhe në vendosjen e gjyqtarëve në Këshillin Penal në gjykatën më të madhe penale në vend.

Aktkonstatimi nga mbikëqyrja e kryer tregoi se numri më i madh i parregullsive është zbuluar në punën e Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup, por edhe në Gjykatën Supreme të RMV-së, kurse në Gjykatën e Apelit në masë të madhe janë respektuar aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj sfere. Në fakt në vijim është duke u bërë përditësimi dhe përmirësimi i sistemit për shpërndarje automatike të lëndëve gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet manipulimi dhe zbatimi i padrejtë në kuptimin e kurdisë së gjyqtarëve joadekuat për marrjen e vendimeve për lëndë të caktuara.

PROKURORIA SPECIALE PUBLIKE

Komiteti i Helsinkit e ka monitoruar punën e Prokurosisë Speciale Publike edhe gjatë vitit 2018. Komiteti ka regjistruar se në vitin 2018 përfundimisht filluan rastet gjyqësore sipas të gjithë aktakuzave të parashtruara nga ana e PSP-së dhe të aprovuara nga ana e gjykatës. Në këtë vit u miratuan akgjykimet në shkallë të parë të rasteve „Tanku“, „Tifani“, „Trust“ dhe „Treqind“, kurse Gjykata e Apelit e konfirmoi aktgjykimin e lëndës „Tanku“, me të cilën ish-kryeministri Nikolla Gruevski u dënua me dy vjet burg efektiv. Mirëpo, arratisja e të dënuarit që ndodhi në rrethana krejtësisht të dyshimta ishte dënuar fuqishëm nga Komiteti i Helsinkit dhe të gjitha organizatat partnere që punojnë në monitorimin e gjyqësorit dhe reformave të tij. Komiteti dhe organizatat e tjera u kanë bërë thirrje institucioneve të sistemit, në veçanti Prokurorisë Publike, gjykatës dhe policisë, për të hetuar çështjen plotësisht dhe në themel dhe, nëse gjendet përgjegjësi për persona dhe institucione të caktuara, të ndjekin procedurat e duhura dhe t'i mbajnë ata përgjegjës. Sidoqoftë, përkundër kërkesave të drejtuara publikisht institucioneve kompetente, deri në fund të vitit 2018 ata nuk dhanë ndonjë përgjigje konkrete se si personi i dënuar arriti të largohej nga vendi. Në vitin 2018, PSP-ja i mori çështjet “Monstra” dhe “Spot” nga Prokuroria Themelore Publike. Që nga rifillimi i procedurave gjyqësore

për rastin “Monstra”, Komiteti ndoqi të gjitha seancat gjyqësore me vëmendje të veçantë dhe arriti në përfundimin se deri në fund të vitit provat e Prokurorisë ishin riparaqitur, të cilat ishin prezantuar në procedurën e mëparshme, me publikun e përfshirë këtë herë gjatë paraqitjes së të gjitha provave, përfshirë marrjen në pyetje të dëshmitarit të mbrojtur, inspektimin e automjetit dhe të gjitha provat e tjera, me kërkesë të një vëzhguesi të Komitetit të Helsinkit, dhe pas marrjes së dakordimit nga pjesëmarrësit në procedurë. Vitin e ardhshëm, do të fillojë prezantimi i provave të marra me masat e PI, prezantimi i provave të paraqitura tashmë të mbrojtjes dhe prezantimi i provave të reja të prokurorisë. Megjithëse SPS-ja mori përsipër nga Prokuroria Themelore Publike edhe lëndën “Sopot”, përsëri gjatë vitit 2018, dmth menjëherë pas marrjes së saj, SPS-ja hoqi dorë nga ndjekja penale për këtë aktakuzë. Ky veprim provokoi një seri reagimesh në publik, media dhe rrjete sociale. Sidoqoftë, përkundër zvogëlimit të pengesave për rastet e SPS-së, të cilat Komiteti vuri në dukje vitin e kaluar, në disa procedura praktika e shtyrjes së seancave ishte akoma e dukshme, veçanërisht në rastet „Target/Kështjella“ dhe „Titanik“. Në vitin 2018 Prokuroria Speciale Publike ngriti dhjetë hetime të reja. Për ngritjen e tyre, opinionet u ndanë midis ekspertëve dhe praktikuesve ligjorë - nëse në bazë të ligjit të posaçëm për krijimin dhe dhënien e juridiksionit për këtë prokurori, hetimet e reja mund të hapen pas 18 muajsh apo jo. Në lidhje me këtë çështje, avokatët mbrojtës të disa prej të dyshuarve në rastet e SPS-së paraqitën një kërkesë për një mendim juridik në parim në Gjykatën Supreme të RMV-së për interpretimin e kësaj dispozite. Deri në fund të vitit, Gjykata e Supreme ende nuk kishte vepruar dhe nuk kishte dhënë përgjigje iniciativës së këtyre mbrojtësve. Duke qenë se kjo iniciativë në fakt është një kërkesë për interpretim autentik, Komiteti është i mendimit se Gjykata Supreme e RMV-së nuk ka mandat për këtë, sepse të drejtën për interpretim autentik të ligjeve në RMV e ka vetëm ligjvënësi, përkatësisht Kuvendi. Nga hetimet e sapo nisura, vëmendja e publikut profesional dhe e gjerë u përqëndrua kryesisht në hetimin e lëndës së re të SPS-së, “Perandoria”. Hetimi për çështjen përfshiu ish zyrtarë dhe biznesmenë pranë qeverisë së atëhershme dhe disa prej të dyshuarve iu caktua paraburgimi për shkak të rrezikut të ndikimit në dëshmitarë, fshehjes së provave ose ndikimeve të ndryshme në hetim. Avokatët e mbrojtjes dhe të dyshuarit të cilët u mbajtën në paraburgim u ankuan për mënyrën në të cilën u urdhërua mbajtja e tyre, dmth, pa thirrjen dhe pyetjen e të dyshuarve dhe pa u paraqitur atyre provat në bazë të të cilave SPS-ja kërkoi dhe gjykata lejoi paraburgimin. Këshilli Penal dhe Gjykata e Apelit nuk e pranuan këtë argument të mbrojtjes së këtyre të dyshuarve dhe ata qëndruan në paraburgim deri në fund të dhjetorit 2018, kur SPS-ja kërkoi që ndalimi i dy të dyshuarve të zëvendësohej me arrest shtëpiak, sepse arsyet për përcaktimin e paraburgimit tashmë nuk ekzistojnë. Edhe pse sipas Planit 18 dhe Strategjisë për reforma në sistemin gjyqësor 2017-2022, por edhe sipas rekomandimeve të KE

dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, një nga përparësitë në reformën gjyqësore duhet të ishte rregullimi i statusit të SPS-së, deri në fund të vitit 2018 asnjë ligj nuk u miratua e cila do të zgjidhë statusin e kësaj prokurorie. Sidoqoftë, Komiteti vë në dukje dhe u rekomandon vendimmarrësve që sa më shumë që zgjidhja e statusit të kësaj prokurorie të vonohet, aq më shumë i mbetet mundësia mandatit të SPS-së të përfundojë me ligj dhe kështu të rrezikojë të gjitha çështjet ekzistuese dhe procedurat e hapura para hetimore dhe hetimore. Komiteti vëren se në gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për SPS-në, duhet të merret parasysh pavarësia dhe aftësia e saj për të trajtuar raste kaq komplekse dhe të gjera. Suksesi i kësaj prokurorie, ndër të tjera, është për shkak të stafit të saj me burime njerëzore dhe me liri dhe mundësi financiare.

PROKURORIA PUBLIKE

Pavarësisht zgjedhjes së Prokurorit të ri Publik të Shtetit në fund të vitit 2017, gjatë vitit 2018 nuk pati ndryshime të rëndësishme në funksionimin e Prokurorisë, veçanërisht jo në drejtim të fillimit të procedurave të reja kundër korrupsionit ose akteve të abuzimit të detyrës. Është e rëndësishme të theksohet se edhe me zhvendosjen e deklaruar në Prokurorinë Publike, disa çështje ende mbetën të mbërthyera në sirtarët e prokurorëve. Kështu, për shembull, përkundër paraqitjes së dy urgjencave nga Komiteti i Helsinkit për përpunimin e kallëzimeve penale për sulmet ndaj Qendrës LGBTI nga vitet 2012-2014, ne përsëri morëm një përgjigje nga zyra e prokurorit themelor se procedurat janë ende në vazhdim, dhe urgjenca e dorëzuar në Prokuroria e Lartë Publike nuk ka përgjigje. Duke qenë se akoma nuk janë ngritur akuza kundër asnjë prej autorëve të veprës, krijohet përshtypja se Prokuroria nuk po punon për këto çështje me kujdesin e veçantë të nevojshëm për të kryer një hetim të plotë dhe në themel.

Komiteti i Helsinkit vlerësoi pozitivisht paraqitjen e aktakuzës nga Prokuroria Themelore Publike Shkup - Departamenti për Krim të Organizuar dhe Korrupsion kundër 33 të pandehurve për ndërhyrjen në Parlamentin e RMV-së më 27 prill 2017 dhe ndoqi seancat në këtë rast me vëmendje të veçantë. Sidoqoftë, nga ana tjetër, Komiteti dënoi amnistinë e shumicës së të pandehurve në këtë ngjarje penale-juridike në kurriz të negociatave politike në lidhje me votimin për ndryshimet kushtetuese në Kuvendin e RMV-së. Ky trajtim i njerëzve të caktuar në vend dhe

miratimi i ligjit me të cilin këta të pandehur u amnistuan shkel parimin e shtetit të së drejtës, shkatërron shtetin e ligjit dhe mbështet mosndëshkueshmërinë dhe selektivitetin në përgjegjësinë e qytetarëve sipas ligjit. Gjatë vitit 2018, Komiteti i Helsinkit vazhdoi të ngrejë padi penale në Prokurorinë Publike dhe të kërkojë që ajo të fillojë procedurat sipas detyrës zyrtare për rastet e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut. Edhe për këtë vit, mbetet vërejtja se Prokuroria është një institucion pasiv dhe i mbyllur, i cili pasohet nga mosrespektimi i afateve të përcaktuara ligjërisht me Ligjin për Procedurën Penale, i cili parashikon një periudhë prej gjashtë muajsh për kryerjen e hetimit, i cili fillon nga dita e miratimit të urdhëresës. Në shumicën e rasteve të regjistruara këtë vit, të cilat kanë të bëjnë me tejkalimin e kompetencave të policisë, përdorimin e tepruar të forcës nga policia, gjuhën e urrejtjes dhe veprimet e urrejtjes, ne nuk kemi një përgjigje adekuate nga agjencitë e zbatimit të ligjit. Sidoqoftë, Komiteti vëren se Prokuroria po fillon një trend pozitiv në njohjen, regjistrimin dhe përpunimin e rasteve të caktuara të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes. Sidoqoftë, vërejtja mbetet se drejtësia zbatohet në mënyrë selektive edhe këtu, kështu që shpejtësia dhe angazhimi i Prokurorisë, për shembull, në akte të regjistruara të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes kur viktimat ose figurat politike dhe publike preken në shoqërinë tonë është më e madhe sesa kur bëhet një fjalë në lidhje me urrejtjen etnike midis të miturve dhe urrejtjen ndaj njerëzve nga komuniteti LGBTI. Duke marrë parasysh praktikën e vazhdueshme të mos kryerjes së hetimeve efektive në rastet e sjelljes joadekuate të zyrtarëve të autorizuar të policisë, u miratuan ndryshimet e lartpërmendura në Ligjin për Prokurorinë Publike, i cili krijoi një mekanizëm të jashtëm, të pavarur për mbikëqyrjen e veprimeve të paligjshme të policisë dhe përdorimin e tepruar të forcës nga policia. Ky ndryshim në sferën e prokurorisë publike është pjesë e një pakete ndryshimesh në shtatë ligje përmes të cilave duhet të sigurohet korniza ligjore për krijimin e këtij mekanizmi (Ligji për Policinë, Ligji për Punët e Brendshme, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve, Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Shërbimet në Prokurorinë Publike, Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për Gjykatat). Sidoqoftë, deri në fund të vitit 2018 nuk kishte të dhëna se si të zbatohen këto ndryshime ligjore që duhet të sigurojnë kontroll më të madh mbi autoritetet policore. Prandaj, Komiteti thekson se reformat vlerësohen në kuptimin e mënyrës se si zbatohen risitë, dhe jo vetëm në lidhje me atë se a bëhen ndryshime apo jo. Pavarësisht selektivitetit, Komiteti mirëpret njohjen nga Zyra e Prokurorit Publik të elementeve të gjuhës së urrejtjes në gjashtë çështje, si dhe fillimin e hetimeve dhe procedimeve penale në to. Në rastin e gjuhës së urrejtjes në lidhje me zjarrin në Greqinë fqinje, Prokuroria ka ngritur një aktakuzë kundër personit me iniciale M.N, por procedimet nuk kanë filluar ende para gjykatës kompetente. Në përgjithësi, megjithëse ka pasur disa përmirësime, sjellja e Prokurorisë mund të vlerësohet si jo mjaft efikase dhe jotransparente, pra prapë dështon në rolin e saj për të qenë mbrojtës i të drejtave

dhe lirive të qytetarëve.

LIGJET PËR AMNISTI

Pas miratimit të projektligjit për amnisti për të burgosurit në RMV vitin e kaluar, në janar të vitit 2018 ai u miratua nga Kuvendi i RMV-së. Ky ligj përfshinte të dënuarit që janë dënuar me burgim deri në gjashtë muaj (të cilët lirohen plotësisht nga vuajtja e dënimit), të dënuarit që janë dënuar me burgim prej më shumë se gjashtë muaj (të cilët lirohen nga vuajtja e 30% të i gjithë dënimi i shqiptuar nga një aktgjykim i formës së prerë), ndërsa personat e dënuar të cilët janë dënuar me një dënim të vetëm me burg me një vendim të formës së prerë lirohen nga vuajtja e një dënimi të vetëm me burg prej 30% në pjesën e dënimeve individuale të përcaktuara më parë të përfshira në amnisti. Ligji gjithashtu specifikon që nëse i vetmi dënim është burgimi për një krim që nuk i nënshtrohet amnistisë, i dënuari do të lirohet nga vuajtja e dënimit me 30% vetëm në pjesën e dënimeve individuale të përcaktuara më parë të mbuluara nga amnistia. Neni 3 qartë shpjegon se amnistia nuk vlen për personat e dënuar me burgim të përjetshëm dhe i rendit veprat që do të përjashtohen nga procesi, siç janë vepra penale vrasje (neni 123 i Kodit Penal); veprat kundër zgjedhjeve dhe votimit (neni 158-165-v të KP-së), veprat kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor (neni 186, 187, 188, 189, 191, 193, 193-a, 193-b dhe 194 të KP-së); veprat kundër shtetit (neni 305-327 të KP-së); veprat kundër rendit publik (neni 394-a-394-g, të KP-së); si dhe veprat kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare (neni 403-418-a dhe prej 418-v deri 422 të KP-së). Për të dënuarit që po vuajnë një dënim me burg, procedura për lirim ose uljen e dënimit me burg filloi ex officio nga institucioni i vuajtjes së dënimit, dhe për ata që nuk filluan vuajtjen e dënimit me burg - u iniciua nga gjykata që e kaloi atë me aktgjykimin e shkallës së parë sipas detyrës zyrtare, me kërkesë të prokurorit publik ose me kërkesë të personit të dënuar. Të pakënaqur me vendimet e miratuara për amnisti kishin të drejtë ankese brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, i cili mund të paraqitet nga personi i dënuar dhe personi i cili mund të paraqesë një ankese në favor të personit të dënuar. Zbatimi i këtij ligji shkaktoi një problem më të madh, veçanërisht pasi njerëzit që kaluan një kohë të gjatë në institucion u liruan nga burgju pa përgatitjen e duhur dhe një plan për risocializimin dhe përfshirjen në jetën shoqërore jashtë institucionit të mbyllur. Personat e caktuar që u rehabilituan nga ky ligj u liruan nga institucioni pa dokumente të vlefshme identifikimi, gjë që më tej shkaktoi probleme në integrimin dhe risocializimin e këtyre njerëzve në

jetën në liri. Ky është një rrezik real i recidivizmit midis këtyre njerëzve, i cili në planin afatgjatë nuk do të arrijë qëllimin kryesor të këtij ligji, që është adresimi i mbipopullimit në burgje. Megjithatë, reagimet më të fuqishme i shkaktoi Ligji për amnistinë u miratua në fund të vitit 2018, i cili u dha mundësinë 33 të pandehurve në çështjen gjyqësore për 27 prill të lirohen nga përgjegjësia. Ky ligj nuk përfshinte organizatorët e veprimeve kriminale, ata që mbanin armë ose kryen dhunë në Kuvendin e RMV-së, si dhe ata që abuzuan me pozitën e tyre zyrtare. Sidoqoftë, ky ligj “shpëtoi” të gjithë deputetët e akuzuar dhe personat e tjerë që morën pjesë në vepër, por që nuk u përjashtuan nga dispozitat e mësipërme. Komiteti i Helsinkit dënoi fuqimisht miratimin e një ligji të tillë dhe vuri në dukje se me këtë ndërhyrje, pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ ndërhyjnë në pavarësinë e gjyqësorit dhe shkelën rëndë parimin e shtetit të së drejtës. Komiteti thekson se miratimi i një ligji të tillë vetëm konfirmoi mosndëshkimin dhe pozicionin e privilegjuar të kategorive të caktuara të qytetarëve dhe konfirmoi se ligjet në RMV nuk zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.

MONITORIMI I PROCESIVE GJYQËSORE

Komiteti i Helsinkit vazhdoi të monitorojë proceset gjyqësore në vitin 2018, veçanërisht proceset kur ka shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Fokus i veçantë u vu në monitorimin e veprave nga urrejtja, gjuhës së urrejtjes, diskriminimit, dhunës në familje, shkeljes së të drejtave të komunitetit LGBTI dhe të ngjashme. Po japim një përmbledhje të veçantë nga monitorimi i këtyre proceseve:

Rasti „E enjtja e përgjakshme“ ose „Ndërhyrja në Kuvendin e RMV-së më 27 prill 2017“

Nga fillimi i seancave gjyqësore, Komiteti i Helsinkit me kujdes të veçantë e ka monitoruar diskutimin kryesor për këtë lëndë. Komiteti për disa herë me rradhë vuri në dukje se ka shkelje të të drejtave të pandehurve në këtë procedurë, mirëpo pas reagimeve të mbrojtjes dhe ekspertëve, gjykata e korrigjoi veprimin e saj. Në fillim të gjykimit, monitoruesit e Komitetit vunë në dukje edhe shkeljen e të drejtave të personave të paraburgosur. Për shkak të kohëzgjatjes së seancave ndodhte që të paraburgosurit nuk mund të dilnin jashtë gjatë tërë ditës, dhe më shqetësuesja (siç alarmuan disa prej mbrojtësve të këtyre personave) ata me orë të tëra ishin pa ushqim dhe lëngje, megjithëse institucioni i burgut dhe gjykata e kanë për obligim t'i sigurojnë ato. Gjykata

i obligoi shërbimet e burgut që të sigurojnë ushqim të mjaftueshëm për këta persona gjatë kohëzgjatjes së seancave, dhe si rezultat kjo mangësi u korrigjua. Komiteti gjithashtu vuri në dukje se gjykata në periudha të caktuara e shkeli të drejtën e mbrojtjes cilësore për shkak të kohëzgjatjes „maratonike“ të seancave, ndonjëherë edhe mbi 10- 12 orë. Megjithatë, gjithmonë duhet të kihet parasysh se pesha e lëndës, vëllimi i saj, fakti që një pjesë e të panehurve janë në paraburgim, si dhe numri i madh i të pandehurve dhe dëshmitëve të parashtruara nga prokuroria dhe mbrojtja, ndikojnë në intensitetin e përcaktimit dhe kohëzgjatjes së seancave. Me Ligjin e lartëpërmendur për Amnisti për ngjarjet e 27 prillit, nga gjithsej 33 të pandehur në këtë proces, mbetën edhe 17 të pandehur. Disa prej tyre, megjithëse kishin mundësi të parashtrorjës së kërkesës për amnisti, sepse nuk u përfshinë me dispozitën përjashtuese, nuk parashtruan kërkesë, duke lënë që gjykata të vendos për fajin e tyre.

Rasti „Monstra“

Pasi që Gjykata Supreme e RMV-së e pranoi kërkesën e prokurorit përgjegjës publik dhe e ktheu rastin „Monstra“ për vendimmarrje të sërishme para gjykatës themelore, lëndën nga Prokuroria Themelore Publike e mori PSP-ja. Komiteti i Helsinkit e monitoroi edhe procedurën paraprake, madje edhe procedurën e përsëritur që nga fillimi i saj. Megjithëse gjatë seancës dëgjimore të dëshmitarit të mbrojtur, gjykata fillimisht deshi ta përjashtojë publikun nga këto seanca, me kërkesë të monitoruesit të Komitetit, gjykata, me dakordimin paraprak të pjesëmarrësve në procedurë e rishikoi vendimin e saj dhe lejoi që procedura të jetë publike, madje edhe për publikun e gjerë. Me këtë veprim gjykata tregoi se këtë procedurë mund ta mbarëvajtë në mënyrë transparente, duke respektuar të drejtat e të dëmtuarve dhe të pandehurve. Megjithëse gjatë përsëritjes së procedurës PSP-ja kërkoi ekstradimin e të pandehurit të parë dhe të dytë, dhe gjykata është në komunikim të vazhdueshëm me ministrinë kompetente dhe kërkesa për ekstradim në shtetin fqinj është parashtruar që nga fillimi i procesit, ekstradimi i tyre nuk është bërë akoma. Kjo shkaktonte një lloj revolte dhe mosbesim te prindërit dhe përfaqësuesit e viktimave ndaj gjykatës dhe institucioneve të sistemit, megjithëse një vendim i tillë në këtë fazë nuk varet nga institucionet tona kombëtare, por nga institucionet e shtetit fqinj ku qëndrojnë të arratisurit.

Rasti „Tamara Dimoska“

Në vitin 2018, Prokuroria Themelore Publike pranoi pjesërisht akuzat penale kundër mjekëve dhe përgjegjësve në FSSH për përgjegjësinë penale për vdekjen e vajzës Tamara Dimoska nga Velesi. Gjegjësisht, Prokuroria Publike konstatoi se ekziston një dyshim i arsyeshëm për përgjegjësi penale të mjekëve që vendosën në komisione, si dhe të atyre që ishin përgjegjës në FSSH, por që

nuk ka arsye për dyshim tek ish-Ministri i Shëndetësisë N.T. Komiteti i Helsinkit ka apeluar kundër këtij vendimi në Prokurorinë e Lartë Publike, por ende nuk ka marrë një përgjigje për ankesën. Përndryshe, në tremujorin e fundit të vitit 2018, filloi procedimi gjyqësor kundër mjekëve të akuzuar dhe personave përgjegjës nga FSSh-ja, e cila u shty disa herë për shkak të mungesës së mjekëve për shkak të detyrave dhe udhëtimeve të ndryshme zyrtare, dhe deri në fund të vitit procedura e dëshmime ishte ende në fazën e parashtrimit të dëshmimeve nga prokuroria. Komiteti i Helsinkit e ndjek këtë procedurë me vëmendje të veçantë, jo vetëm për faktin se ka ngritur kallëzime penale për fillimin e kësaj aktakuze por edhe për faktin se veprime të tilla të personave dhe institucioneve të caktuara rrezikojnë seriozisht shëndetin e qytetarëve të RMV-së dhe i vënë në pikëpyetje jetët e tyre.

Rasti „Gjuha e urrejtjes për zjarret në Greqi “

Komiteti mirëpriti vendimin e Prokurorisë Publike për të ngritur akuzë kundër M.N. për përhapjen e urrejtjes dhe intolerancës racore, kombëtare dhe fetare përmes përhapjes së gjuhës së urrejtjes, në lidhje me zjarret që shpërthyen verën e kaluar në Greqi. Seancat dëgjimore para gjykatës kompetente nuk u filluan deri në fund të vitit 2018, por Komiteti përmes vëzhguesve të tij do t'i ndjekë ato me vëmendje të veçantë, duke pasur parasysh se numri i procedurave penale për gjuhë të urrejtjes në RMV është shumë i vogël dhe për faktin se për momentin janë duke u ndërtuar praktikat gjyqësore dhe duke u ndryshuar ligjet për këto vepra.

Rasti „Sazdo“

Rasti kur një i ri u rrah në një stacion autobusi në Shkup nga tre bashkëmoshtarë të tij dhe si rezultat i plagëve të tij ra në një gjendje kome dhe vdiq dhjetë ditë më vonë, Komiteti i Helsinkit e ka regjistruar atë si një krim urrejtjeje për shkak të përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës dhe autorëve të veprës. Në fillim, Prokuroria Publike e cilësoi këtë akt si dhunë, por pas vdekjes së të riut, e rikualifikoi atë si një vrasje të kryer në një mënyrë mizore. Sidoqoftë, as policia dhe as prokuroria, në asnjë fazë të procedimit, nuk e dokumentuan këtë rast si një vepër të kryer nga urrejtja. Komisioni ka ndjekur procedurën gjyqësore për çështjen “Sazdo” me vëmendje të veçantë që nga fillimi dhe vëren me shqetësim se gjykata vazhdimisht shkel ashpër dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale. Gjegjësisht, që nga fillimi i seancës kryesore për këtë procedurë, vëzhguesit e Komisionit vunë re se trupa e gjyqtarëve, posaçërisht kryetari i trupës së gjyqtarëve, e zhvillon procedurën sipas Ligjit për Procedurën Penale, i cili ishte i vlefshëm deri në vitin 2013, dhe jo sipas Ligjit të ri për Procedurën Penale, që filloi të zbatohet në dhjetor të vitit 2013, dhe sipas së cilës duhet të

udhëhiqet ky proces. Shkelja e tillë e rëndë e ligjit procedural mund të rrezikojë tërë procedurën dhe, nga njëra anë, të çojë në mosndëshkim të autorëve për shkak të shkeljeve procedurale, dhe nga ana tjetër, të rrezikojë të drejtat e të pandehurve në procedurë. Komiteti i Helsinkit thekson se gjykata në çdo procedurë, përfshi edhe këtë, duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme dhe në mënyrë rigorozë t'i përmbahet dispozitave të procedurës, në mënyrë që të garantojë një gjykim të drejtë për të pandehurit, dhe për palët e dëmtuara dhe viktimën të garantojë mbrojtjen e të drejtave të tyre, e cila do të kënaqë drejtësinë dhe nuk do të rrezikojë asnjë aktgjykim të mundshëm. Deri në fund të vitit 2018, procesi ishte në fazën e prezantimit të dëshmimeve nga ana e prokurorisë.

Nga çështjet e vëzhguara deri më tani dhe seancat dëgjimore përkatëse, Komiteti vëren se, megjithëse të drejtat e pjesëmarrësve në procedurat penale, në veçanti të të pandehurve, të dëmtuarve dhe viktimave, respektohen në përgjithësi, vihet re se në disa raste (veçanërisht në sa më sipër) nga pjesëmarrësit dhe mosrespektimi i dispozitave të procedurës penale. Kjo ishte e dukshme në procedurat e zhvilluara në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të vitit 2010 me aplikim nga viti 2013. Gjegjësisht, ishte e dukshme që disa nga gjyqtarët dhe trupat e gjyqtarëve nuk veprojnë siç duhet në përputhje me këtë ligj, madje disa bëjnë shkelje serioze të procedurës, duke u udhëhequr nga parimet dhe dispozitat e ligjit të vjetër, megjithëse ata duhet të zhvillojnë procedurat sipas LPP-së së re. Sidoqoftë, ishte i dukshëm mosveprimi ose veprimi në kundërshtim me dispozitat e LPP-së së re si nga prokuroria ashtu edhe nga mbrojtësit në procedurë. Në disa raste, kjo u shpjegua me pamundësinë për të zbatuar disa dispozita për shkak të mungesës së pajisjeve dhe aftësive të përshtatshme teknike. Prandaj, Komiteti rekomandon që, përkundër trajnimeve të shumta të kryera deri më tani për zbatimin e LPP-së së re për gjyqtarët, avokatët dhe prokurorët, nevojitet trajnim i mëtejshëm, si dhe korrigjimi për lëshime të tilla nga gjykatat më të larta. Respektimi dhe zbatimi i duhur i ligjeve është një nga elementët kryesorë të parimit të shtetit të së drejtës, kështu që gjykatat duhet të sigurojnë zbatimin uniform të ligjeve procedurale. Kështu, ato do të kontribuojnë në respektimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe do të forcojnë sigurinë juridike të qytetarëve.



PROCESE PARA GJEDNJ-së

PROCEDURA TË INICUARA/APLIKIME TË PARASHTRUARA

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2018 përgatiti dhe paraqiti një kërkesë për shkelje të të drejtave të njeriut përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strazbur. Ky është një rast kur një fëmijë dhjetë vjeçar është abuzuar fizikisht dhe verbalisht nga stafi mjekësor gjatë një ndërhyrje mjekësore në një spital në brendësi të vendit. Megjithëse çështja u raportua menjëherë së pari në polici dhe më pas në zyrën e prokurorit kompetent, prokuroria hodhi poshtë akuzat penale. Pasi ishin konsumuar të gjitha mjetet juridike të brendshme, aplikanti i mitur, me ndihmën juridike të Komitetit të Helsinkit dhe një avokati, paraqiti

një kërkesë me kohë në GJEDNJ në Strazbur. Kërkesa u pranua si e lejuar dhe është në fazën e vendimit para Gjykatës Evropiane.

KOMUNIKIMI ME GJEDNJ-në PËR APLIKIMET VIJUESE

Në lëndën X and Y kundër Maqedonisë, ngritur për brutalitet policor kundër aplikantëve, Komiteti i Helsinkit u thirr si një ndërmjetës i palës së tretë (third party intervention), pas së cilës Komiteti i Helsinkit përgatiti komunikimin dhe e paraqiti atë në gjykatë brenda afatit të paraparë. Në lëndën Boshkovski kundër Maqedonisë, në muajin prill 2018 Komiteti i Helsinkit, si përfaqësues i aplikantit, parashtoi vërejtje me shkrim në GJEDNJ brenda afatit të dhënë, duke arsyetuar pretendimet e bëra nga shteti në vërejtjet e tij me shkrim.

PROCESE TË PËRFUNDUARA NË GJEDNJ

Për rastin Zhaklina Dimovska kundër Maqedonisë, deri në Gjykatën Evropiane është parashtruar njoftim se Prokuroria Themelore Publike Shkup ka filluar procedim penal kundër personave të denoncuar për shkak të dyshimit të bazuar se ata me anë të veprimit, respektivisht lëshimit janë fajtorë për përkeqësimin e gjendjes shëndetësore dhe vdekjes së vajzës së mitur të aplikantes. Pas kësaj, gjykata deri te Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka dërguar shkresë me të cilën na ka informuar se kërkesa nuk është lëshuar dhe se lënda mbyllet.

Për rastin Fërçkovski kundër Maqedonisë, ku aplikanti kishte parashtruar kërkesë deri te Gjykata për shkak të realizimit të lustrimit kundër tij, gjatë vitit 2018 GJEDNJ-ja kërkoi përgjigje nëse vallë aplikanti i qëndron edhe më tej kërkesës së parashtruar, për të cilën është dërguar një përgjigje e rregullt. Pas këtij komunikimi, Gjykata Evropiane miratoi vendim se kërkesa nuk është lejuar dhe se lënda mbyllet.

EKZEKUTIMI I AKTGJYKIMEVE TË GJEDNJ-së

Në vitin 2017 GJEDNJ-ja miratoi aktgjykim për lëndën e Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (KOO), respektivisht Kryepeshkopatës Greko-Ortodokse të Ohrit pranë Patriarkanës së Pejës, i cili u bë i plotëfuqishëm në muajin prill të vitit 2018. Deri në përmbylljen e këtij raporti, Aktgjykimi i GJEDNJ-së 3532/07 ende nuk është ekzekutuar në tërësi, respektivisht nga ana e shtetit janë paguar kompensimi monetar dhe shpenzimet e shqiptuara nga gjykata, mirëpo kisha edhe më tej nuk është regjistruar në regjistrin përkatës, kurse vetë procesi është në vijim e sipër.



**TRAJTIMI I
BARABARTË**

DISKRIMINIMI NË VITIN 2018

Gjatë vitit 2018, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut monitoroi vazhdimisht situatën në fushën e diskriminimit në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që të parandalojë dhe mbrojë nga diskriminimi duke ofruar ndihmë juridike për viktimat e diskriminimit, duke informuar publikun për rastet e diskriminimit dhe trajtimin dhe efektivitetin e mekanizmave kundër diskriminimit. Për më tepër, përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit morën pjesë në grupin e punës për hartimin e një projektligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Pasqyra e përgjithshme sa i përket mbrojtjes dhe parandalimit të diskriminimit në vitin 2018 korrespondon me atë të vitit 2017, gjë që vetëm tregon se shteti nuk i jep përparësi diskriminimit si fushë për përmirësim dhe avancim. Përveç pranimit të rasteve për diskriminim, Komiteti veprroi edhe në rastet që regjistroi përmes monitorimit të mediave, rrjeteve sociale, shpalljeve të vendeve të punës dhe monitorimit të gjendjes së shoqërisë, politikave dhe praktikave ekzistuese. Gjatë vitit u dokumentuan gjithsej 22 raste të diskriminimit, që reflektojnë problemet sistemore për romët, gratë, veçanërisht gratë të bashkësive etnike pakicë dhe nënave vetushqyese, personat me aftësi të kufizuara dhe bashkësite fetare joshumicë. Sipas të dhënave statistikore, është e dukshme se numri më i madh i rasteve i referohenin diskriminimit bazuar në gjini dhe seks, aftësi të kufizuar, përkatësi etnike dhe status familjar dhe martesor. Lidhur me fushat në të cilat ka ndodhur diskriminimi, më të zakonshmet janë aksesin në mallra dhe shërbime, i ndjekur nga punësimi, arsimit dhe shëndetësia. Shoqatat e qytetarëve vazhduan të jenë më aktive në ngritjen e vetëdijes dhe informimin e qytetarëve për diskriminimin dhe masat mbrojtëse. Vazhduan reagimet dhe raportet mbi situatën me diskriminim nga Avokati i Popullit, kurse nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi në këtë pjesë kishte një pasivitet absolut.

DISKRIMINIMI NË AKSESIN NË MALLRA DHE SHËRBIME

Në këtë sferë u identifikuan disa raste të diskriminimit lidhur me aksesin në mallra dhe shërbime për arsye të ndryshme. Është shqetësuese që trendi i kufizimit të aksesit ndaj mallrave dhe shërbimeve për romët vazhdoi edhe më tej bazuar në përkatësinë e tyre etnike, një problem që u identifikua gjithashtu edhe në vitin 2017. Këtë herë ishte fjala për kufizimin e hyrjes në kafe-bar në Prilep, për të cilën u krye

një testim i situatës. Testimi tregoi që testuesit romë ishin parandaluar të hynin në kafënë, me shpjegimin se të gjitha tavolinat e lira në momentin kur testuesit u përpoqën të hynin në kafënë ishin të rezervuara. Nga ana tjetër, testuesit kontrollues, të cilët ishin maqedonas, u lejuan të hyjnë në kafene dhe u shërbyen nga stafi. Në këtë rast, Komiteti i Helsinkit filloi një procedurë para Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Procedura është ende në proces e sipër. Një rast tjetër kishte të bënte me diskriminimin bazuar në statusin personal, familjar dhe moshën me rastin e hyrjes në Muzeun e iluzioneve “Iluzium” për nënën vetushqyese dhe fëmijën nën 14 vjeç. Lista e çmimeve të muzeut ofron çmime promocionale për biletat familjare për familjet me dy prindër që kanë dy fëmijë, ndërsa për familjet me një prind nuk janë ofruar çmime të tilla promocionale. Gjithashtu, lista e çmimeve të muzeut ofron një zbritje të çmimeve të biletave për fëmijët nën 14 vjeç, ndërsa një zbritje e tillë nuk u ofrua për fëmijët nën 14 vjeç. Komiteti i Helsinkit filloi një procedurë për këtë rast para Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e cila, për fat të keq, përfundoi negativisht, dmth Komisioni miratoi një mendim se në rastin specifik nuk ka diskriminim. Rasti i tretë kishte të bënte me diskriminimin e bazuar në fe dhe besimin fetar në aksesin në restorantin Portofino Osteria dhe Bar nga një vajzë e veshur me hixhab. Gjegjësisht, në këtë rast, restoranti nuk lejonte hyrjen e një vajze që mbante hixhab dhe e cila shoqërohej nga disa shoqe që nuk mbanin hixhab, me arsyetimin se të gjitha tavolinat në restorant janë të zëna, megjithëse shumica e tavolinave në restorant ishin të lira në atë kohë. Gjysmë ore pasi nuk u lejohej hyrja, një nga mikeshat e vajzës së diskriminuar u kthye në restorant dhe u pranua në restorant pa ndonjë problem. Komiteti i Helsinkit filloi një procedurë për këtë rast përpara Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Komisioni miratoi një mendim pozitiv që konstatoi diskriminim dhe rekomandoi që ky diskriminim të eliminohet. Komisioni urdhëroi gjithashtu që restoranti t’i kërkojë falje publike vajzës së diskriminuar. Falja e restorantit u botua në një gazetë ditore.

DISKRIMINIMI NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Numri më i madh i rasteve të dokumentuara të diskriminimit në këtë fushë ishin ato bazuar në gjini dhe seks dhe i referoheshin grave. Në rastin e parë, bëhej fjalë për diskriminim ndaj grave që kanë përdorë pushim lehonie dhe për këtë arsye nuk është paguar regresi për pushimin vjetore (K-15) nga punëdhënësit. Sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për sektorin privat në fushën e ekonomisë, çdo punonjës që ka punuar te një punëdhënës për të paktën gjashtë muaj në vitin

aktual ka të drejtën e regresit për pushim vjetor. Disa punëdhënës, përfshirë Organizatën e Punëdhënësve, interpretuan në mënyrë arbitrare këtë dispozitë të marrëveshjes kolektive, dmth ata konsideruan se mungesa për shkak të shtatzënisë, lehonisë dhe prindërimit nuk plotëson kërkesën për gjashtë muaj punë të vazhdueshme të njëjti punëdhënës. Një interpretim i tillë u praktikua gjithashtu edhe nga disa njësi rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës. Për faktin se gratë kryesisht përdorin të drejtën e pushimit për shkak të shtatzënisë, lehonisë dhe prindërimit, një interpretim i tillë i dispozitave të marrëveshjes kolektive përbën diskriminim në bazë të gjinisë dhe seksit. Duke ndjekur procedurën e iniciuar nga Komiteti i Helsinkit për interpretimin autentik të Marrëveshjes Kolektive, Komisioni për interpretimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për sektorin privat në sferën e ekonomisë vendosi që gratë që kanë shfrytëzuar pushim për shtatzëni, lehonitë dhe prindërim të njëjti punëdhënës në vitin aktual, ato kanë të drejtën e regresit për pushim vjetor. Rasti tjetër ka të bëjë me diskriminimin ndaj një gruaje me aftësi të kufizuara fizike për aksesin në vendin ku ajo kryen detyrat e saj. Gjegjësisht, pala është e punësuar në një kompani për mirëmbajtjen e higjienës dhe kryen aktivitetet e saj të punës në disa kate në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Për shkak se një nga ashensorët në ministri ishte jashtë përdorimit, pala kishte vështirësi të hynte në vendin ku ajo supozohej të kryente detyrat e saj. Pas reagimit të Komitetit të Helsinkit, Ministria largoi pjesërisht difektin e ashensorit dhe i njëjti ishte i përdorshëm deri në katin e parë të ministrisë. Duke pasur parasysh faktin se kjo situatë e bën edhe të vështirë për klienten që të hyjë në vendin ku duhet të kryejë detyrat e saj, Komiteti i Helsinkit mbetet në komunikim me Ministrinë për riparimin e plotë të ashensorit dhe sigurimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuara fizike.

DISKRIMINIMI NË SHËNDETËSI

Rasti më indikativ i dokumentuar i diskriminimit në fushën e shëndetësisë në këtë vit ishte rasti i diskriminimit nga Spitali i përgjithshëm në Strumicë ndaj grave bazuar në statusin familjar dhe martesor. Gjegjësisht, në repartin obstetrik të spitalit, ku pranohen pacientët, u bë një njoftim që pacientët që vijnë në repartin obstetrik duhet të sjellin një certifikatë nga libri amë i të martuarve. Me këtë njoftim, spitali diskriminoi dhe ngacmoi në bazë të statusit familjar dhe martesor. Komiteti i Helsinkit iu drejtua Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i kërkuar Komisionit të hetojë nëse spitali, sipas kësaj deklarate, ofron shërbime shëndetësore

vetëm për pacientët shtatzënë që janë të martuar dhe që mbajnë një certifikatë martesë, dhe gratë shtatzëna që nuk janë të martuara ose për arsye të ndryshme nuk mund të sjellin një certifikatë, nuk mund të marrin shërbime, dmth nëse këto gra nuk mund të lindin në spital. Komiteti i Helsinkit gjithashtu dërgoi një reagim në spital, duke kërkuar heqjen e këtij njoftimi. Spitali, menjëherë pasi mori reagimin, largoi njoftimin diskriminues.

LIGJI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Ky vit u shënuar me shtyrjen e miratimit të ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Projektligji u parashtrua në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në muajin maj të vitit 2018 nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, pas një procesi gjithëpërfshirës të hartimit të projektligjit që përfshinte të gjithë aktorët aktivë, përfshirë përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit. Në kundërshtim me të gjitha rekomandimet ndërkombëtare dhe premtimet nga Qeveria dhe shumica parlamentare se ligji do të miratohet deri në fund të vitit 2018, ligji nuk u miratua në këtë periudhë raportuese. Në seancën e fundit të Komisionit për Punë dhe Politikë Sociale në Kuvend në vitin 2018, deputetja nga partia DOM paraqiti një propozim që ky ligj të vendoset si pika e parë në rendin e ditës dhe të hapet një debat sa i përket kësaj zgjidhje ligjore. Deputetët nga partia politike VMRO-DPMNE, një deputet nga partia BDI dhe një deputet nga partia PCER votuan negativisht kundër propozimit për ta vendosur ligjin si pikën e parë në rendin e ditës të seancës së Komisionit. Në seancën e Komisionit, ndër të tjera, anëtarët kishin zhvilluar diskutim mbi kundërshtimet e ligjit në fjalë me religjionin, që vetvetiu paraqet një skandal, duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë është një shtet laik. Megjithatë, rezultati përfundimtar i diskutimit ishte vendosja e ligjit në rend të ditës, por si pikë e katërt, që përsëri nënkuptonte shtyrje të procedurës për miratimin e ligjit. Këtij vendimi të Komisionit i parapriu shmangia për disa herë e ligjit që të vendoset në rendin e ditës nga kryetari i Komisionit. Rekomandimet për miratimin e këtij ligji dhe harmonizimin e legjislacionit tjetër janë pjesë e raportit të Komisionit Evropian dhe u vlerësua pozitivisht nga Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës. Për më tepër, një nga vërejtjet e Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW) në rekomandimet dhe konkludimet përfundimtare drejtuar shtetit i referohej procesit të ngadaltë të miratimit të ligjit. Shtyrja e vazhdueshme e rishikimit dhe miratimit të ligjit gjithashtu shtyu edhe avancimin e

mbrojtjes që u ofrohet qytetarëve në raste diskriminimi. Duke prurë debatin nëse ligji do të vihet në rendin e ditës për shqyrtim nga ana e Komisionit dhe duke përdorur argumentin se ligji është në kundërshtim me bindjet fetare tregoi mungesën e seriozitetit nga ana e deputetëve dhe mungesën e vullnetit për të miratuar një ligj që do të sigurojë në mënyrë gjithëpërfshirëse parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.



***GJUHA E
URREJTJES***

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2014 filloi me zbatimin e aktiviteteve në lidhje me monitorimin dhe regjistrimin e gjuhës së urrejtjes në të gjithë vendin. Në vitin 2018, Komiteti iu qas krijimit të një mekanizmi gjithëpërfshirës për hartëzimin dhe dokumentimin e këtyre fenomeneve negative sociale në përgjigje të trendit në rritje të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në mediat sociale. Metodologjikisht, monitorimi dhe raportimi i gjuhës së urrejtjes dhe incidenteve të urrejtjes u zhvillua përmes mjeteve interaktive të internetit www.govornaomraza.mk dhe www.zlostorstvaodomraza.mk. Për të siguruar besueshmërinë e denoncimeve, Komiteti i Helsinkit bënte kontrollin dhe aprovimin e materialit të raportuar, pas së cilës të dhënat u bënë pjesë e statistikave përmbledhëse të gjeneruara nga këto vegla interneti. Në vitin 2018, shumica e rasteve të gjuhës së urrejtjes u regjistruan në muajin korrik dhe shtator, veçanërisht në bazë të përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike. Këto muaj përkojnë me negociatat me Republikën e Greqisë dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës, si dhe njoftimin për organizimin e një referendumi.

Tabela – Pasqyrim kohor i regjistrimit të incidenteve lidhur me gjuhën e urrejtjes në vitin 2018





Tabela – Struktura e incidenteve 2018



Nga të dhënat e analizuar është e qartë se gjuha e urrejtjes prodhon veprime urrejtjeje sidomos në bazë të përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike. Në mënyrë të barabartë, të dhënat e mbledhura për gjuhën e urrejtjes, si dhe ato për veprat nga urrejtja tregojnë se shumica e rasteve të regjistruara të gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja ishin kryer në baza etnike dhe më shpesh midis anëtarëve të komuniteteve etnike maqedonase dhe shqiptare. Megjithëse të dhënat e gjuhës së urrejtjes për vitet e kaluara kanë treguar se gjuha homofobike është e pranishme në publik, dhe veçanërisht në rrjetet sociale, viktimat e veprave të urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor në vitet e fundit nuk inkurajohen t'i raportojnë ato as në institucionet kompetente, as para organizatave të shoqërisë civile, për shkak të mosveprimit dhe/ose veprimit joadekuat të institucioneve ndaj kërkesave të deritanishme dhe akteve të raportuara tashmë mbi këto baza dhe mbrojtjes joadekuate të viktimave.

Gjithashtu, në vitin 2018, gjuha e urrejtjes nga politikanët gjatë debateve publike dhe fushatave politike shpesh rezultoi në vepra të urrejtjes të kryera nga mbështetësit dhe simpatizantët e tyre. Në garën për sensacionalizëm dhe lexueshmëri, mediat i harrojnë detyrimet e tyre ligjore dhe etike për të filtruar përmbajtjet që ata i transmetojnë publikut dhe të mos shërbejnë si një kanal për përhapjen e gjuhës diskriminuese dhe të urrejtjes.

GJUHA E URREJTJES DHE VEPRA TË URREJTJES NDAJ MIGRANTËVE

Gjatë vitit 2018, edhe pse në numër më të vogël krahasuar me vitin e kaluar, thirrjet për dhunë, fyerje dhe gjuhë ksenofobe ndaj refugjatëve dhe migrantëve ishin të pranishme në publik. Komiteti i Helsinkit në portalin www.govornaomraza.mk regjistroi tre raste të gjuhës së urrejtjes drejtuar refugjatëve dhe migrantëve. Intensiteti i gjuhës së urrejtjes dhe fyerjet ndaj refugjatëve ishte më i përhapuri në rrjetet sociale. Në një nga rastet e regjistruara, bëhet fjalë për statusin në Facebook të një profesori në Fakultetin e Drejtësisë “Justiniani i Parë¹”. Në statusin e shkruar, profesori i quan migrantët hajdutë, përdhunues dhe paralajmëron qytetarët se, tani, kur të vendosen këtu në vend, do të duhet të durojnë të gjitha ato gjëra. Gjuha e urrejtjes përhapet më tej në komentet e postimit të saj. Në dy rastet e tjera, është një foto e përbashkët e refugjatëve që krahasohen me qen në një mënyrë fyese që nënçmon, fyen dhe përhap të pavërteta dhe paragjykime². Fotoja u shpërnda në një faqe në Facebook që synonte promovimin e të drejtave të refugjatëve.

1 <http://www.govornaomraza.mk/reports/view/943>.

2 Ibid



**VEPRA NGA
URREJTJA**

Në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2018, Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 123 vepra të kryera nga urrejtja, që është pothuajse një dyfishim i numrit të veprave krahasuar me vitin 2017. Nga gjithsej 123 incidente, deri në fund të vitit u verifikuan 60, ndërsa 63 mbetën të paverifikuara. Përndryshe, procesi i verifikimit të incidenteve u zhvillua përmes kërkimit të informacionit dhe përgjigjes së duhur me anë të shkresave nga Ministria e Brendshme, si dhe monitorimit të rregullt të buletineve ditore të Ministrisë dhe raporteve të mediave për incidente të caktuara. Vepra të paverifikuara, megjithatë, u regjistruan për shkak të ekzistimit të animit që kishin të bënin me perceptimin e viktimës/dëshmitarit, dallimet midis autorit dhe viktimës për nga përkatësia etnike ose përkatësia politike, mungesa e motiveve të tjera të mundshme, shpeshtësia e incidenteve të ngjashme, dhe vendndodhja dhe koha e kryerjes së veprave të tilla. Shumë nga incidentet e paverifikuara kanë të bëjnë me incidente në zona të përziera etnike, lagje dhe shkolla, në autobusë ose pranë stacioneve të autobusëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për linjat e autobusëve të përdorura nga njerëz që i përkasin bashkësive të ndryshme etnike etj. Për më tepër, incidentet e paverifikuara mbeten të njohura për nga lloji i incidentit (sulme në autobusë ose stacione të autobusëve, rrahje midis dy grupeve ose sulmi nga një grup i të miturve mbi një tjetër ose më shumë viktimë, etj.). Sa i përket motiveve të kryerjes së veprës nga urrejtja, 64% e incidenteve ishin kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, dhe këto janë incidente janë më të shumta, kurse pas tyre vijojnë incidentet që ishin kryer për shkak të përkatësisë politike të viktimës dhe që përbëjnë një të kartën e numrit të përgjithshëm të incidenteve (25%). Në rradhë për nga numri janë incidentet e shkaktuara për shkak të intolerancës racore, etnike dhe fetare (13,8%), incidentet e kryera për shkak të statusit të migrantit/refugjatit (4,8%), fesë dhe besimit fetar (3,2%). Këtë vit është regjistruar edhe një rast i veprës nga urrejtja për shkak të aftësive fizike/mendore të viktimës (0,8%). E përmendim se këtë vit (2018) nuk kishte asnjë incident të kryer vetëm për shkak të orientimit seksual të viktimës. Numri i incidenteve të urrejtjes të kryera për shkak të përkatësisë politike ose bindjeve politike të autorëve/viktimave është veçanërisht i dukshëm para dhe gjatë vendimeve të caktuara politike, të tilla si miratimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, nënshkrimi i Marrëveshjes së Prepsës, Referendumi i vitit 2018 dhe votimi i ndryshimeve kushtetuese në Kuvend. Në vitin 2018, shumica e incidenteve të regjistruara (67) përmbushin elementët e veprës penale - dhunë (sepse ato ishin kryer në ambient të hapur, para shumë njerëzve, për shembull në një oborr të shkollës, në një stacion autobusi në kohë me frekuencë të madhe, në një autobus, në ndeshje sporti, etj.). Sidoqoftë, shumica e incidenteve të tilla nga agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht ato midis të rinjve dhe të miturve, klasifikohen si kundërvajtje dhe kështu nuk regjistrohen si vepra të urrejtjes në të dhënat zyrtare statistikore të shtetit. Kualifikimi i tillë i këtyre veprave nuk është një përgjigje adekuate nga shteti dhe autorëve u dërgohet një mesazh

që ata ose nuk do të mbajnë përgjegjësi ose se sanksionimi i tyre është i vogël, duke mos përmbushur kështu qëllimet e dënimit - të veprojnë në mënyrë parandaluese si për autorët ashtu edhe për kryesit e ardhshëm të veprave të tilla. Dëmtimi i pronës është raportuar në 26 incidente, më së shpeshti në incidentet kryera për shkak të përkatësisë politike ose fesë dhe besimit fetar (dëmtimi i automjeteve, shtëpive, objekteve të tjera, ndërtesave fetare ose qeveritare dhe selive të partive politike). Nga 123 incidente të regjistruara, në 18 incidente viktimat morën lëndime trupore, dhe një person humbi jetën si rezultat i lëndimeve trupore të marra, në fund të qershorit të vitit 2018. Ky lloj i pasojave më së shpeshti regjistrohet në vepra që shkaktohen për shkak të përkatësisë etnike. Në veçanti, në rastin e tifozit të ri, i cili u sulmua, u rrah dhe humbi jetën si rezultat i lëndimeve nga tre bashkëmoshatarë të tij të etnisë shqiptare, Komiteti i Helsinkit parashtroi disa shkresa në Prokurorinë Publike kompetente në mënyrë që me këtë rast të punohet me kujdes të veçantë, për të kryer një hetim të plotë dhe në themel dhe për të ndjekur penalisht autorët në përputhje me dëshmitë e grumbulluara. Komiteti gjithashtu reagoi edhe publikisht me një komunikatë, duke kërkuar arsyeshmëri midis të dy grupeve etnike dhe duke dënuar gjuhën e urrejtjes, veçanërisht nga figurat publike dhe figurat politike, duke thënë se një fjalim i tillë mund të çonte vetëm në një përshkallëzim të dhunës dhe viktimave shtesë të veprave nga urrejtja. Çështja fillimisht u kualifikua si dhunë, dhe pas vdekjes së djalit të dëmtuar u kualifikua si vrasje në një mënyrë mizore. Procedura para gjykatës së shkallës së parë është ende duke vazhduar. Rrezikimi i sigurisë si vepër është vërejtur në 15 incidente të urrejtjes, dhe këto janë përsëri raste kur vepra ka ndodhur për shkak të përkatësisë politike të viktimës ose autorit. Madje 11 raste kanë përmbushur elementët e veprës së nxitjes së urrejtjes etnike, racore dhe fetare, dhe disa nga këto incidente janë proceduar siç duhet nga agjencitë e zbatimit të ligjit (policia dhe prokuroria). Grabitja si vepër penale është regjistruar në gjashtë raste të regjistruara të incidenteve ndaj refugjatëve/migrantëve. Është regjistruar një rast i shkakimit të rrezikut të përgjithshëm duke i vënë flakën automjetit të një politikani. Në vitin 2018, vazhdon trendi që autorë të veprave nga urrejtja të jenë kryesisht të rinj dhe të mitur. Një përqindje e konsiderueshme prej 36% e viktimave janë persona nën moshën 18 vjeç, dhe ka incidente kur viktimat ishin 12-13 vjeç. Në rastet e tjera, shumica e viktimave janë persona të rinj. Nuk është i papërfillshëm as numri i autorëve të mitur të veprave të urrejtjes, kështu që nga 319 autorë të regjistruar, 72 ishin persona të mitur, që është pothuajse një e katërta e numrit të përgjithshëm të autorëve (22%).

Ky është një indikator serioz se toleranca midis të rinjve është nën nivel, veçanërisht te të rinjtë me përkatësi të ndryshme etnike (zakonisht midis të rinjve me përkatësi etnike maqedonase dhe shqiptare). Institucionet kompetente me vëmendje të veçantë duhet ta ndjekin këtë fenomen dhe trend, të punojnë në parandalimin

e një trendi të tillë të padëshiruar përmes futjes së programeve edukative për bashkëjetesë dhe tolerancë, nga një anë, dhe nga një tjetër, t'i regjistrojnë dhe në mënyrë adekuate t'i kualifikojnë incidentet nga urrejtja ku viktimat dhe/ose autorët janë persona të mitur dhe të rinj, plotësisht dhe në themel t'i hetojnë dhe me kujdes të kryejnë mbarëvajtjen e procedurave që të fajësuarit të dënohen në përputhje me ligjin në një procedurë të drejtë, të paanshme dhe objektive në bazë të dëshmive dhe pa ndonjë dyshim të arsyeshëm. Në këtë mënyrë, publikut dhe të rinjve do t'ia dërgojnë porosinë e duhur se dhuna nga urrejtja nuk tolerohet dhe se secili që të kryejë vepra të tilla do të sanksionohet në mënyrë adekuate. Numri më i madh i incidenteve nga gjithsej 123 incidente janë regjistruar në Shkup (85 ose 69%). Pas tyre vijnë Prilepi (11), Kumanova (4), Tetova (4), Velesi, Negotina, Manastiri dhe Vinica (2) dhe Strumica, Kërçova, Tabanovca, Mavrova, Gjevgjelia, Demir Hisari, Gostivari, Dellçeva dhe Ohri (1). Nga incidentet e regjistruara në Shkup, madje 20 kanë ndodhur në territorin e Komunës së Gazi Babës, 19 në Çair, 17 në Qendër, shtatë në Aerodrom, Karposhi dhe Buteli me nga pesë incidente të urrejtjes, Kisella Voda dhe Gjorçe Petrov nga katër secila, Haraçina, Studeniçani, Çuçer Sandevo dhe Petroveci me nga një incident nga urrejtja.

Numri i vetëm 24 autorëve të zbuluar nga Ministria e Brendshme, kundër të cilëve u ngritën kallëzime penale, në vetëm tetë nga incidentet e regjistruara të urrejtjes ka qenë një dështim i madh. Ky është një tregues serioz që Ministria e Brendshme dhe Prokuroria Publike duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje dhe të punojnë më shumë në raste të tilla, për të vepruar me zë dhe për të kryer hetime në kohë, të shpejta, të plota dhe gjithëpërfshirëse. Krimet nga urrejtja kanë implikime të mëdha dhe afatgjata shoqërore. Kur identifikohen më shumë autorë dhe vendosen para drejtësisë, trajtimi i këtij fenomeni do të bëhet më efektiv.



INSTITUCIONE TË MBYLLURA

Gjatë mandatit të tij, Komiteti i Helsinkit edhe në vitin 2018 vazhdoi të monitoronte situatën nëpër burgje. Bashkëpunimi midis Komitetit të Helsinkit dhe Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve u forcua duke nënshkruar një Memorandum bashkëpunimi. Gjatë vitit, u vërejtën disa përmirësime në lidhje me situatën në institucionet e vuajtjes së dënimit, veçanërisht në drejtim të zvogëlimit të mbipopullimit në burgje pas miratimit të Ligjit për Amnistinë në janar të vitit 2018. Sidoqoftë, kushtet ndaj të cilave të burgosurit janë të ekspozuar gjatë qëndrimit dhe vuajtjes së dënimit të tyre vazhdojnë të jenë në kundërshtim me standardet e trajtimit të vendosura nga të gjitha instrumentet përkatëse ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

MBIPOPULLIMI NË BURGJE DHE TRAJTIMI JOADEKUAT

Miratimi i Ligjit për Amnisti në fillim të vitit adresoi çështjen e mbipopullimit në burgje. Sipas të dhënave nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, rreth 800³ të dënuar që po vuanin dënimin me burg ishin përfshirë nga ky Ligj. Lidhur me numrin e të burgosurve, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, deri më 31 dhjetor 2018, numri i përgjithshëm i personave të dënuar ishte 1.954 në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese. Kapaciteti i përgjithshëm i të gjitha institucioneve ndëshkimore-korrektuese është 2.026 persona të dënuar. Shifrat tregojnë një ulje të numrit të të dënuarve me 30% nga viti i kaluar. Sipas të dhënave për periudhën e dhënë, në SHNK Idrizovë numri ishte 1,222 të dënuar, që krahasuar me numrin e 1,786 të dënuarve për vitin e kaluar, tregon një rënie prej 32%. Në pavijonin e grave në SHNK Idrizovë, deri më 31 dhjetor 2018, ishin vendosur gjithsej 53 gra të dënuara. Gjatë vitit 2018, objektet e reja u hapën në SHNK Idrizovë për të akomoduar 546 persona të dënuar. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, objektet e reja janë parashikuar si pavijone të hapura dhe gjysmë të hapura, me qeli me katër shtretër dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nga krahasimi i të dhënave zyrtare për periudhën e dhënë, të cilat i referohen kapacitetit hapësinor, krahasuar me numrin e të dënuarve të vendosur në institucionet përkatëse të vuajtjes së dënimit jashtë Shkupit, tejkalimi i kapacitetit të institucionit është vënë re në burgjet në Strumicë (33%), Shtip (11%) dhe Tetovë (29%), megjithëse këto shifra, krahasuar me vitin e kaluar, tregojnë një rënie të ndjeshme, respektivisht numri është ulur për më shumë se 100% në secilin institucion në veçanti. Pavarësisht uljes së mbipopullimit në burgje, problemi i higjienës dhe kushteve joadekuate në burgjet që nuk ishin objekt i rindërtimit, po vazhdon edhe më tej. Gjatë vizitave të bëra nga përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit dhe përmes bisedave me të dënuarit, u vu re problemi me kushtet joadekuate sanitare nëpër qeli, ajrosja e pamjaftueshme, si dhe shfaqja e mykut dhe lagështisë. Problemi me mungesën e stafit adekuat në burgje, veçanërisht kur bëhet fjalë për edukatorët dhe punonjësit socialë, në korrelacion me programet jo-ekzistuese të risocializimit është një problem sistemik, i cili nëse nuk adresohet si duhet do të vazhdojë të shkaktojë pasoja negative për të burgosurit edhe pas lëshimit të tyre në liri.

Në vitin 2018, përmes një bisede me një grua të burgosur nga SHNK Idrizovë, Komiteti i Helsinkit mori informacionin se gratë e burgosura nuk kanë qasje në telefon për të bërë kontakte me familjet e tyre. Sipas standardeve të CPT-së, “mbajtja

e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore, veçanërisht me familjen dhe miqtë e ngushtë”. Në këtë drejtim CPT-ja e thekson nevojën për fleksibilitet sa i përket vizitave dhe bisedave telefonike, veçanërisht për rastet kur familja e personit të dënuar banon larg institucionit, kështu që për pasojë, bërja e vizitës do të ishte jopraktike. Në raportin e CPT-së për Republikën e Maqedonisë nga viti 2016, si një nga vërejtjet kryesore gjatë vizitave ishte qasja e kufizuar në telefon në burgjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke pasur këtë në mendje, CPT-ja në rekomandimet e saj vuri në dukje se ishte e nevojshme “për t’ju dhënë mundësi të burgosurve dhe familjeve të tyre të mbajnë kontakte me dinjitet dhe respekt, duke respektuar privatësinë e tyre”.

KUJDESI SHËNDETËSOR

Me transferimin e kompetencave tek Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në institucionet e vuajtjes së dënimit, problemi i trajtimit joadekuat shëndetësor të të burgosurve është thelluar. Si rezultat i mungesës së komunikimit midis institucioneve dhe stafit të pamjaftueshëm të personelit mjekësor në burgje, të burgosurit përballen me qasje të vështirë te mjeku dhe marrja e terapive adekuate. Një nga problemet e zakonshme që të burgosurit theksojnë në ankesat e tyre është reagimi i vonuar i institucioneve kur nevojitet trajtim jashtë burgut. Gjegjësisht, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve, personat e dënuar mund të kërkojnë me shpenzimet e tyre që të kryejnë një ekzaminim specialist jashtë institucionit, dhe në të njëjtën kohë, nëse është e nevojshme, ata mund të kërkojnë ndërprerjen e burgimit për trajtim jashtë vendit. Në shumicën e rasteve, të burgosurit nuk marrin fare përgjigje ndaj kërkesave të tyre dhe kur marrin një përgjigje, është tepër vonë dhe ata humbin takimin në institucionin shëndetësor. Veprimi i vonuar i institucionit mund të shkaktojë dëmtime shtesë të gjendjes shëndetësore të personit të dënuar. Lidhur me numrin e personave të dënuar në institucionet penitenciare që janë përdorues të terapisë me metadon, janë 232 persona, deri në dhjetor të vitit 2018. Nga të dhënat e marra nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, 50 persona të infektuar me hepatit C u regjistruan në burgje. SHNK Shtip ka regjistruar 35 të dënuar të infektuar me hepatit C, SHEK Tetovë - pesë, SHNK Kumanovë - tre, SHNK Manastir - dy, ndërsa SHNK Prilep dhe SHNK Gjevgjeli secila me nga një person të infektuar me hepatit C. SHNK Idrizovë nuk ka një numër të saktë të personave të infektuar me hepatit C, por në një bisedë me mjekun e burgut u theksua se rreth 60% e të varurve me metadon

të regjistruar në burg janë të infektuar me hepatit C. Gratë e burgosura ende nuk kanë qasje adekuate në shërbimet shëndetësore dhe, sipas bisedave me ta, ka pasur raste kur mjeku i burgut nuk i ka vizituar ato vazhdimisht për muaj të tërë. Mungesa e një gjinekologu në pavijonin e grave në SHNK Idrizovë mbetet problematike, duke pasur parasysh që gratë që vuajnë dënimin me burg kanë nevojë të veçanta për shëndetin gjinor, jo vetëm në aspektin e shtatzënisë dhe kujdesit para dhe pas lindjes, por edhe në aspektin e shëndetit të tyre riprodhues dhe seksual, si dhe ekzaminimet parandaluese për kancerin e gjirit dhe mitrës. Gjatë vitit 2018, u regjistrua një rast i vdekjes së një gruaje të burgosur, e cila u diagnostikua me kancer dhe u mbajt në qeli për më shumë se dy muaj pa ndihmë mjekësore dhe terapi të përshtatshme. Komiteti i Helsinkit adresoi situatën me kujdesin shëndetësor të grave të burgosura para Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në Gjenevë.

RASTET E VDEKJEVE

Gjatë vitit 2018, në institucionet ndëshkimore-korrektuese u regjistruan nëntë raste vdekjesh. Nga rastet e regjistruara, tre janë regjistruar si vetëvrasje duke u varur në qelinë e tyre. Vdekjet e tre të burgosurve ndodhën në një klinikë, ku ata u dërguan për shkak të përkeqësimit të gjendjes së tyre shëndetësore, dy gjatë përdorimit të privilegjeve (pushim vjetor) dhe një gjatë kohës së arratisjes⁴.

Në Raportin e Tretë të Përgjithshëm⁵, CPT-ja bëri disa rekomandime për parandalimin e vetëvrasjeve në burgje. Gjegjesisht, menaxhmenti i burgut, përfshirë personin përgjegjës për kujdesin shëndetësor në burgje, duhet të sigurojë ndërgjegjësimin e duhur për parandalimin e vetëvrasjeve në strukturën e tyre organizative dhe të parashikojnë procedurat e duhura. Duhet të përpjekje aktive për parandalimin e vetëvrasjeve duke parashikuar monitorimin, mbështetjen dhe zhvillimin e një marrëdhënie besimi midis të burgosurve dhe personelit të burgjeve. Duhet të merren masa për të siguruar bashkërendimin e duhur të përpjekjeve për parandalimin e vetëvrasjeve, veçanërisht përmes takimeve të rregullta dhe të shpeshta midis ekipeve multidisiplinare dhe me kontributin e duhur nga specialistët në kuptimin e psikiatërve dhe edukatorëve. Të burgosurit në rrezik vetëvrasjeje kanë nevojë

4 Skopjeinfo.mk „Vdiq një e burgosur në „Idrizovë“ – e sëmurë nga karcinoma, e cila për dy muaj ka qenë e shtruar në dhomën e burgut pa një kujdes dhe terapi adekuate “ – <https://skopjeinfo.mk/pochina-zatvorenichka-od-idrizovo-bolna-od-karcinom-koja-dva-meseci-le->

5 CPT/Inf (98)12.

për kujdes urgjent mjekësor dhe kanë nevojë për operacione të veçanta vëzhgimi. Neglizhenca në identifikimin e këtyre të burgosurve dhe/ose marrjen e masave të duhura është kritikuar në raportet e CPT-së. Në raste të tilla, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur shkelje të Nenit 2 (e drejta për jetë) dhe/ose Nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose degradues ose ndëshkimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶.

Sipas rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës, çdo vdekje e një të burgosuri duhet të hetohet tërësisht, ndër të tjera, për të përcaktuar shkakun e vdekjes, faktet që çuan në vdekje, përfshirë faktorët kontribues, dhe nëse vdekja mund të ishte parandaluar. Për më tepër, kur një person vdes në burg (ose menjëherë pas transferimit nga burgu), duhet të kryhet autopsia, gjatë së cilës menaxhmenti i burgut dhe shërbimet mjekësore duhet të informohen për rezultatin. Së fundmi, duhet të ndërmerret një analizë e secilës vdekje burgu, për të marrë në konsideratë mësimet e përgjithshme që mund të nxirren në lidhje me burgun në të cilin ndodhi vdekja, dhe nëse në rast të vetë-shkaktimit të vdekjes ka ndonjë masë sistematike në nivelin shtetëror që duhet të merret.

MEKANIZMAT E MBIKËQYRJES

Mungesa e vazhdueshme e mekanizmave efektivë për mbikëqyrje dhe kontroll mbi trajtimin e të dënuarve brenda institucioneve të vuajtjes së dënimit ka rezultuar në ndryshime ligjore në Ligjin për Avokatin e Popullit, Ligjin për Prokurorinë Publike dhe Ligjin për Punët e Brendshme. Ndryshimet në Ligjin për Avokatin e Popullit, votuar më 30 tetor 2018 në Kuvend, parashikojnë krijimin e një mekanizmi për kontrollin civil mbi punën e policisë dhe policisë së burgut. Mekanizmi i kontrollit të jashtëm përfshin tre anëtarë të jashtëm të organizatave joqeveritare, të cilët duhet të kenë përvojë të provuar pune në fushën e të drejtave të njeriut, ligjit policor dhe gjyqësorit. Mekanizmi i Kontrollit Civil parashikohet të ndërmarrë veprime dhe masa për të siguruar mbështetje dhe mbrojtje për viktimën/viktimat, të drejtat e tyre dhe prezantimin e interesave të tyre në të gjitha procedurat, përmes hetimit efikas dhe transparent të krimeve dhe veprimeve të tjera të paligjshme të kryera nga punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë zbatimit të autorizimeve të tyre policore dhe nga anëtarët e policisë së burgut dhe në rastet

6

Keenan v. UK 27229/95; Güveç v. Turkey 70337/01; Riviere v. France 33834/03; Renolde v. France 5608/05; De Donder and De Clippel v. Belgium 8595/06; Dybeku v. Albania 41153/06; Ketreb v. France 38447/09; Mouisel v. France 67263/01; Tarariyeva v. Russia 4353/03.

kur është e nevojshme do të fillojë një rishikim të procedurës para prokurorisë publike kompetente. Megjithëse ndryshimet ligjore kanë hyrë në fuqi, mekanizmi i kontrollit civil nuk është vendosur ende dhe nuk është funksional. Ndryshimet në Ligjin për Prokurorinë Publike, të miratuar më 30 tetor 2018 në Kuvend, parashikojnë krijimin e një njësie speciale për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të kryera nga persona me kompetenca policore dhe anëtarët e policisë së burgut në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në të njëjtën kohë, parashikohet që departamenti të ketë një shërbim të veçantë profesional dhe hetuesë-prokurorë publikë, prokurorë publikë dhe shefi i departamentit i cakton prokurorin publik të Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit, për një periudhë jo më pak se katër vjet. Ndryshimet në Ligjin për punë të brendshme, të miratuar më 30 janar 2018 në Kuvend parashikojnë obligim pas pranimit të kallëzimit penal ose marrjes së informacionit se punonjës i MPB-së me status të nëpunësit policor ose person i autorizuar zyrtar për siguri dhe kundërzbulim me autorizime policore ka bërë veprë penale gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ose veprim jashtë shërbimit duke përsorur kërcënim serioz, forcë ose mjete shtrëngimi dhe si pasojë ka ndodhë vdekje, lëndim i rëndë trupor, lëndim trupor, privim të paligjshëm nga liria, torturë dhe trajtim tjetër mizor çnjerëzor dhe poshtëruës, nëse me ligjin është parashikuar ndjekje penale me detyrim ligjor, Ministria pa asnjë vonesë ta njoftojë departamentin për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të kryera nga personat me autorizime policore ose përfaqësues të policisë së burgjeve në Prokurorinë themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Brenda këtij kuadri, Ministria, së bashku me njoftimin, i paraqet departamentit të gjitha burimet e informacionit në lidhje me krimin e kryer, autorin dhe viktimën dhe burime të tjera të informacionit në dispozicion të saj. Në të njëjtën kohë, ligji përcakton që një procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të një punonjësi në Ministri mund të fillohet me iniciativën e iniciuar nga Avokati i Popullit. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të përmendet se gjatë vitit 2018, një përfaqësues i Komitetit të Helsinkit, së bashku me anëtarët e Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Civile, si dhe përfaqësues të Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe Institutit Kombëtar për Demokraci, më 19 korrik 2018, realizuan një vizitë në SHNK Idrizovë. Gjatë vizitës, deputetët patën mundësinë të njihen me situatën në burg dhe kushtet në të cilat të burgosurit vuajnë dënimin me burg. Komisioni i Përhershëm Anketues njoftoi se ka për qëllim t'i vizitojë të gjitha burgjet në vend dhe konstatimet dhe konkluzionet e tij t'ia paraqesë Kuvendit.

BURGJET PËR PERSONAT E MITUR

Sipas të dhënave zyrtare për vitin 2018, në institucionin edukativo-korrektues për të mitur “Tetovë”, i cili është transferuar përkohësisht në burgun e Ohrit, në tremujorin e parë të vitit ishin akomoduar 18 fëmijë, në tremujorin e dytë 13 fëmijë, dhe në tremujorin e tretë dhjetë fëmijë. Sipas të dhënave të marra nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, objektet e reja të SHEK Tetovë janë ndërtuar plotësisht dhe janë duke u pajisur dhe pritet të përdoren në muajin shtator 2019. Objekti i ri duhet të strehojë fëmijë të cilët janë dënuar - referim në një institucion korrektues, të moshës 14 deri në 23 vjeç. Në ndërkohë, fëmijët janë akoma të vendosur në një institucion ndëshkimor-korrektues ku nuk ka kushte të përshtatshme për arsimimin, risocializimin dhe përmirësimin e tyre, gjë që vë në rrezik risocializimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri. Një sjellje e tillë është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e vendosur gjyqësore të GJEDNJ-së. Gjegjesisht, në Aktgjykimin Blokhin⁷ kundër Rosisë, GJEDNJ konstaton se “privimi nga liria për mbikëqyrje arsimore të të miturve duhet të bëhet në një objekt të përshtatshëm, me burime për të arritur qëllimet e nevojshme arsimore dhe me kushte sigurie”. Sipas gjykatës, “lejohet akomodimi i përkohshëm në objekte që nuk sigurojnë kushte të tilla, mirëpo periudha e privimit nga liria në kushte të papërshtatshme duhet të jetë relativisht e shkurtër, në mënyrë që të i mituri të transferohet në qendër që ofron mbikëqyrje edukative”. Për më tepër, sipas të dhënave zyrtare, tetë raste të hepatitit C janë regjistruar në SHEK Tetovë, gjë që tregon për kushtet joadekuate ndaj të cilave janë të ekspozuar fëmijët të cilët janë duke vuajtur një masë edukative-korrektuese. Lidhur me personat e mitur që vuajnë dënimin me burg, gjatë vitit 2018, në burgun e Ohrit ishin akomoduar shtatë fëmijë. Këta të mitur nuk janë përfshirë në sistemin arsimor dhe janë akomoduar në institucion pa kushte përkatëse për risocializim.

Tortura dhe trajtimi çnjerëzor

Në vitin 2018, në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë u drejtua një palë nga Ohri për të birin e tij, i cili ishte viktimë e përdorimit të tepruar të forcës nga oficerët e policisë nga SPB Ohër. Gjegjesisht, ditën e ngjarjes, gjatë një debati midis palës dhe djalit të saj, ndërhyjnë dy policë nga SPB Ohër, të cilët përdorën forcë të tepruar dhe grushtuan dhe shqelmuan djalin e tyre për rreth 15 minuta, pas së cilës ata thirrën për ndihmë policore dhe së shpejti arritën tre automjete të tjera me policë të tjerë nga i njëjti stacion. Nëna dëshmoi se si djali i saj u hodh në një automjet policie dhe u godit me një

shkop në trupin dhe organet gjenitale. Pala ishte ndaluar për rreth gjashtë orë dhe ishte lënë e lirë pas arritjes së avokatëve të saj, kurse djali i saj ishte mbajtu në stacion policor për 24 orë. Pasi u la i lirë nga stacioni i policisë të nesërmen, ai u dërgua menjëherë te një mjek, ku iu gjet një dëmtim i rëndë në testikulin e majtë, i cili ishte i fryrë dukshëm, si dhe të nxira dhe plagë në të gjithë trupin. Pas analizave të kryera, u realizua një ndërhyrje urgjente kirurgjikale urologjike, me çrast atij iu hoq testikuli i majtë.

Edhe pse ai ishte ankuar për dhimbje ndërsa ishte në stacionin e policisë, nuk u thirr asnjë ambulancë dhe nuk iu ofrua asnjë ndihmë mjekësore. Duke marrë parasysh ankesën e pretenduar, ekzistonte një dyshim i arsyeshëm për sjellje joprofesionale dhe të paligjshme të punonjësve të policisë jashtë kufijve të kompetencave dhe detyrave të tyre, në një mënyrë që degradon dinjitetin njerëzor dhe personalitetin njerëzor përmes përdorimit të tepruar të forcës. Komiteti i Helsinkit u informua se çështja ishte raportuar në Departamentin për kontrollin të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde profesionale dhe se ishte hartuar kallëzim penal nga ana e avokatëve të të dëmtuarit.

- Informimi i publikut dhe organizatave të shoqërisë civile për rolin e ri të prokurorisë në kontrollin e jashtëm të policisë, si dhe inkurajimi dhe motivimi i publikut dhe organizatave të shoqërisë civile për të raportuar raste në lidhje me brutalitetin dhe abuzimin e policisë.
- Veprim dhe trajtim joselektiv i hetimeve të hollësishme dhe në themel për të gjitha rastet dhe ngjarjet për të cilat ekzistojnë bazat e dyshimit se ato përbëjnë ngjarje penale-juridike, pavarësisht nga statusi shoqëror dhe karakteristikat e ngjashme të viktimës ose autorit.
- Përkushtim më i madh i Prokurorisë Publike për të filluar dhe zhvilluar procedura, veçanërisht për incidentet dhe çështjet që lidhen me vepra korrupsioni, gjuhën e urrejtjes dhe dhunën nga urrejtja.

MONITORIMI I GJYKATAVE

- Komiteti rekomandon që, megjithë trajnimet e shumta të deritanishme për zbatimin e LPP-së së re për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, trajnimi i

mëtejshëm është i nevojshëm nga njëra anë, por edhe korigjime për lëshime të tilla nga gjykatat më të larta. Respektimi dhe zbatimi i duhur i ligjit është një nga elementët kryesorë të shtetit të së drejtës, kështu që gjykatat duhet të sigurojnë zbatimin uniform të ligjeve procedurale, të cilat do të kontribuojnë në respektimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe forcimin e sigurisë ligjore të qytetarëve.

DISKRIMINIMI

- Zbatimi i ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
- Rritja e fushatave shtetërore të informimit për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e diskriminimit, manifestimet e tij dhe mekanizmat mbrojtës ndaj diskriminimit.
- Përmirësimi i sistemeve të organeve shtetërore për mbledhjen dhe veçimin e të dhënave në lidhje me rastet e diskriminimit.
- Forcimi i Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke ndryshuar kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit dhe prezantimin e një shërbimi administrativ profesional të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Përmirësimi i ekspertizës dhe profesionalizmit të opinioneve të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke përcaktuar saktësisht llojin dhe formën e diskriminimit dhe konkretizimin më të madh të rekomandimeve për eliminimin e diskriminimit.
- Përmirësimi i aksesit në mbrojtjen gjyqësore përmes ndryshimeve në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, me dispozitat që do të parashikojnë përjashtimin nga tarifat gjyqësore për personat që do të fillojnë procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi.

GJUHA E URREJTJES

- Republika e Maqedonisë ka një kornizë të dobët formale për njohjen dhe sanksionimin e gjuhës së urrejtjes. Procedura gjyqësore dhe parimi i mosndëshkimit tregojnë nevojën për një përcaktim më të qartë të neneve në Kodin Penal që mbulojnë këto vepra penale. Për më tepër, duke pasur parasysh që orientimi seksual si bazë nuk është specifikuar, dhe sipas statistikave është baza e dytë e urrejtjes në vend, ajo duhet të thelsohet në mënyrë eksplicite.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Departamenti për krim elektronik

dhe forensikë dixhitale të marrin një rol proaktiv në parandalimin e gjuhës së urrejtjes të transmetuar ose nxitur në mënyrë elektronike. Në të njëjtën kohë, për të vendosur bashkëpunim më të mirë me vetëqeverisjet lokale dhe për të kujtuar kompetencat e tyre për moslejimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirat publike. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Brendshme të fillojë mbajtjen e statistikave dhe të dhënave mbi bazat e gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja në mënyrë që të analizojë situatën në vend dhe të sigurojë një përgjigje të përshtatshme institucionale ndaj fenomeneve të tilla.

- Prokuroria Publike duhet të veprojë me vëmendje të veçantë dhe të monitorojë treguesit për nxitjen e dhunës së urrejtjes dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes, si pas zërit të dëgjuar ashtu edhe pasi të jenë ngritur kallëzime penale, të kryejë një hetim të plotë dhe në themel për të krijuar një praktikë që do të kontribuojë në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.
- Zhvillimi dhe prezantimi i programeve për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe dhunës së urrejtjes në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë dhe rritja e punës me të rinjtë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë. Nevojitet trajnim për oficerët e policisë, gjyqtarët, prokurorët publik dhe avokatët me qëllim të ngritjes së vetëdijes, njohjes dhe kuptimit të fenomenit të gjuhës së urrejtjes, përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në këtë fushë.
- Dispozitat sanksionuese në Kodin Penal duhet të ofrojnë gjithashtu masa alternative për ndëshkimin e autorëve. Shembuj praktikë të punës vullnetare në organizatat e shoqërisë civile me autorë të krimit në bazë të urrejtjes ndaj një individi ose grupi japin rezultate më të mëdha në procesin e ri-integritit dhe rehabilitimin e autorëve të krimit përveç burgimit ose gjobitjes së shqiptuar.
- Mediat dhe gazetarët duhet të kenë mekanizma rigorozë për të kontrolluar dhe refuzuar gjuhën e urrejtjes në informacionin që ata shpërndajnë. Mediat dhe gazetarët që nxisin ose përhapin gjuhë urrejtjeje duhet të sanksionohen siç duhet në përputhje me dispozitat e Kodit Penal. Shoqatat e qytetarëve, Këshilli i etikës së mediave dhe shoqatat e gazetarëve të marrin rolin primar në drejtim të vendosjes së standardeve të larta etike dhe morale sa i përket shkrimeve dhe informimit të publikut.

VEPRA NGA URREJTJA

- Institucionet dhe organet kompetente duhet të promovojnë ndryshimet në legjislacionin penal si për qytetarët ashtu edhe për profesionistët që zbatojnë këto ligje si avokatët, prokurorët, oficerët e policisë dhe gjyqtarët, por edhe organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që të njihen të gjithë me këto ndryshime pozitive.
- Të sigurojë hetim dhe ndjekje penale në kohë dhe efektive të autorëve të veprave të urrejtjes, përmes zbatimit të ndryshimeve të reja në Kodin Penal në lidhje me ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave të urrejtjes.
- Të inkurajohen viktimat që të raportojnë veprat e urrejtjes dhe të sigurojnë masa për ndërtimin e besimit në polici dhe institucione të tjera shtetërore.
- Të dokumentohen dhe publikohen siç duhet të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për veprat e urrejtjes
- Sigurimi i mbrojtjes dhe mbështetjes së duhur për viktimat e veprave të urrejtjes në të gjitha fazat e procedurës.
- Të sigurohen trajnime të përshtatshme për praktikuesit që vijnë në kontakt me viktimat e urrejtjes për të siguruar ndihmën e duhur për viktimat.
- Më e rëndësishmja, zbatimi i aktiviteteve dhe masave që do të kontribuojnë në parandalimin e veprave të urrejtjes, veçanërisht përmes futjes së trajnimit, edukimit dhe mësimave të përshtatshme në programet arsimore.

INSTITUCIONE TË MBYLLURA

- Respektimi i detyrueshëm i standardeve të vendosura për kushtet në të cilat të dënuarit po vuajnë dënimin me burg, veçanërisht për sa i përket higjienës, ajrosjes dhe ndriçimit adekuat, ndarjes së tualeteve, shfaqjes së lagështisë dhe mykut në qeli, etj.
- Angazhimi i personelit të duhur në institucionet e vuajtjes së dënimit, veçanërisht në drejtim të risocializimit dhe punës individuale me të burgosurit, siç janë edukatorët, punonjësit socialë dhe psikologët.
- Ministria e Shëndetësisë vazhdimisht të marrë rolin dhe detyrimin e saj për të siguruar kujdes të duhur shëndetësor në sistemin penitenciar.

- Sigurimi i kujdesit shëndetësor për gratë e burgosura në lidhje me nevojat e tyre shëndetësore specifike gjinore, jo vetëm për sa i përket shtatzënisë dhe kujdesit para dhe pas lindjes, por edhe për sa i përket shëndetit të tyre riprodhues dhe seksual, si dhe ekzaminimet parandaluese për kancerin në gji dhe mitër.
- Rritja e ndërgjegjësimit midis udhëheqësisë së burgjeve për nevojën për një program të përshtatshëm për parandalimin e vetëvrasjeve.
- Të vendoset një procedurë e përshtatshme për vlerësimin e mirëqenies së të burgosurve në mënyrë që të parandalohen vetëvrasjet në burgje.
- Krijimi dhe funksionalizimi i menjëhershëm i Mekanizmit të kontrollit civil në Avokatin e Popullit.
- Hapja e menjëhershme e objektit të ri për Shtëpinë edukativo-korrektuese Tetovë në Vollkovi dhe transferimi i fëmijëve të cilët po vuajnë masën korrektuese në SHNK Ohër.
- Ministria e Arsimit të respektojë detyrimin e saj për të organizuar dhe financuar arsimimin e personave të dënuar.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE

- Komiteti i Helsinkit thekson rolin e rëndësishëm të reagimit të shpejtë dhe me kohë të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe nevojën për përcaktimin e saktë të situatës faktike nga ana e tij. Komiteti gjithashtu inkurajon punëtorët të përdorin mekanizmat ligjorë në dispozicion të tyre për të mbrojtur të drejtat e tyre të punës. Në këtë drejtim, është e nevojshme që punëtorët të informohen në mënyrë përkatëse në lidhje me legjislacionin pozitiv të punës.
- Për shkak të numrit alarmant të lëndimeve të punëtorëve në punë, Komiteti i Helsinkit u bën apel të gjithë punëdhënësve që të respektojnë rregullat në përputhje me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve, veçanërisht në vendet e punës, natyra e të cilëve është me rrezik të lartë për shëndetin dhe jetën e punëtorëve.
- Procedura në kontestet nga marrëdhënia e punës bazohet në parimet e përparësisë dhe urgjencës dhe, megjithëse gjykata ka një detyrim ligjor sipas nenit 405 të Ligjit për marrëdhëniet e punës për t'i kushtuar vëmendje të veçantë nevojës për zgjidhjen e tyre urgjente, praktika tregon se kontestet nga marrëdhënia e punës zgjasin shumë gjatë. Komiteti i Helsinkit ua bën me dije detyrimin për vendimmarrje nga gjykata e shkallës së parë brenda

- afatit gjashtë muajsh, dhe nga gjykatat e shkallës së dytë brenda afatit tridhjetë ditësh në kontestet e punës të jetë një rregull që do të respektohet në mënyrë të përpiktë.
- Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh se mobingu është një fenomen i zakonshëm me pasoja të rënda, dhe deri më tani ekziston vetëm një aktgjykim në Republikën e Maqedonisë me të cilin konstatohet mobing, Komiteti i Helsinkit thekson se mungesa e praktikës gjyqësore në këtë fushë i dekurajon punëtorët që të raportojnë ngacmimet psikologjike në vendet e punës.

GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT

- Përmirësim i efikasitetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës, përmes zbatimit më të plotë dhe më të azhurnuar të procedurave të mbikëqyrjes inspektuese.
- Përmirësim i bashkëpunimit ndër-sektorial të organeve shtetërore (Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria e të Hyrave Publike, Policia Financiare) në procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.
- Përmirësim i aksesit në drejtësi të grave punëtore nga industria e tekstilit duke ulur shpenzimet procedurale dhe administrative për fillimin e procedurave gjyqësore për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve.
- Përbushje e standardeve minimale për kushtet, sigurinë dhe shëndetin në punë nga punëdhënësit, në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

BARAZIA GJINORE

- Zbatim i plotë dhe gjithëpërfshirës i Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, brenda afatit të përcaktuar, me përfshirje aktive dhe angazhim të të gjithë aktorëve, përveç Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, ahtu edhe të Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë, organeve gjyqësore, vetëqeverisjes lokale, përfshi edhe

miratimin e Ligjit për dhunë bazuar në gjini, i cili do të mbulojë edhe dhunën në familje, sipas standardeve që i parashikon Konventa e Stambollit.

- Sensibilizim i përfaqësuesve të organeve kompetente për të njohur dhunën me bazë gjinore dhe për të marrë masa dhe aktivitete për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.
- Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente për të sensibilizuar dhe marrë parasysh nevojat e kategorive të prekshme të grave, veçanërisht gratë shtatzëna, gratë me fëmijë të vegjël dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, nënat e vetme, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rurale, gratë që përdorin drogë, punonjëset e seksit, migrantet, refugjatet, lezbiket, gratë biseksuale dhe transgjimore, gratë që jetojnë me HIV, gratë e pastreha, fëmijët dhe kategoritë e tjera të grave të cenueshme me rastin e marrjes së masave për parandalimin e dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje.
- Qendra për punë sociale për të demonstruar një qëndrim të ndjeshëm ndaj viktimave të dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe për të informuar viktimën për të drejtat dhe shërbimet në dispozicion të saj dhe për të propozuar masa mbrojtëse.
- Shteti duhet që ta vendosë më lartë në Agjendë komponentën gjinore gjatë negociatave për anëtarësim në Bashkim dhe të luftojë aktivisht për çrrënjosjen e çdo lloji të diskriminimit ndaj grave.
- Të vendoset krijim politikash dhe ligjesh, planifikim buxhetor duke përfshi me përgjegjësi komponentën gjinore.

MIGRANTËT, REFUGJATËT DHE AZILKËRKUESIT

- Braktisja e praktikës së “dëbimit” të paligjshëm të grupeve të refugjatëve dhe migrantëve në vendet fqinje, pa vendosur bashkëpunim ndërkufitar me shërbimet e sigurisë. Kjo paraqet një shkelje e të drejtave themelore të njeriut dhe lirive të migrantëve dhe trajtimit çnjerëzor. Të gjitha procedurat e kthimit (riatdhesim) duhet të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe të kryhen në bashkëpunim midis shteteve.
- Të fillohet operacionalizimi i Planit të veprimit për Integrimin e refugjatëve dhe të huajve 2017-2027 për një periudhë më të shkurtër kohore.
- Nevojiten masa për të ndikuar në opinionin publik mbi krizën e refugjatëve, duke pasur parasysh nivelin e lartë të ksenofobisë në mesin e qytetarëve, mungesën e vetëdijes për të drejtat e refugjatëve dhe migrantëve, arsyet e

ikjes së tyre dhe problemet me të cilat përballen. Është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe qasja në informacion në lidhje me krizën, e cila do të ulte intolerancën dhe gjuhën e urrejtjes.

- Pranimi selektiv i refugjatëve në qendrat e pritjes dhe tranzitimit nuk duhet të praktikohet. Ndhima humanitare dhe mbrojtja ndaj rreziqeve të sigurisë duhet të ofrohet për të gjithë refugjatët dhe migrantët që lëvizin nëpër vend në mënyrë që të shmanget vënia e tyre në rrezik shtesë.
- Refugjatët dhe migrantët që kalojnë nëpër vend nuk duhet të kufizohen në lëvizjen e tyre dhe të ndalohen në mënyrë të paligjshme si dëshmitarë në procedurat penale kundër kontrabanduesve.

NDIHMA JURIDIKE FALAS

- Projektligji për ndihmën juridike falas duhet të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe kur të miratohet ligji, të gjitha komentet e bëra nga shoqatat e autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike falas duhet të konsiderohen dhe të merren parasysh seriozish.

QENDRA LGBTI

- Zbatim i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe harmonizim të ligjeve të tjera me këtë ligj.
- Monitorim i zbatimit të ligjit nga ana e institucioneve për barazi që kanë kompetenca të veprojnë në rastet e diskriminimit.
- Zhvillim i sistemit për dokumentimin e gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja, përfshi edhe veprat penale bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.
- Të përmirësohet hetimi dhe ndjekja penale e veprave të urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor dhe të zgjidhen në mënyrë efektive rastet ekzistuese.
- Futje e trajnimeve të rregullta dhe të përhershme brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe qendrave për punë sociale për trajtimin e viktimave të dhunës LGBTI dhe përfshirja e këtij lloji të trajnimit në programin e rregullt të trajnimit për zyrtarët nga të dy institucionet.
- Futje e trajnimit të detyrueshëm brenda Akademisë për Gjuqtarë dhe

Prokurorë Publikë për trajtimin e rasteve të dhunës kur viktimat janë njerëz të komunitetit LGBTI.

- Njohje e thelluar me problemet dhe nevojat e komunitetit dhe me mënyrat se si të mbrohen ata.
- Miratim i një ligji të veçantë për njohjen ligjore të gjinisë në bazë të vetëvendosjes dhe pa kusht për sigurimin e dokumentacionit mjekësor për ndryshimin e gjinisë, ose
- Ndryshim i zgjidhjeve ekzistuese ligjore në Ligjin për regjistrat amë, Ligjin për emrin personal dhe Ligjin për numrin unik amë të qytetarit duke prezantuar një procedurë të thjeshtuar për ndryshimin e këtyre të dhënave përmes dorëzimit të dokumentacionit te një organ dhe duke përfunduar procedurën para të njëjtit organ që do të funksionojë zyrtarisht, i cili pastaj do t'i bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme të kërkuara nga pala.

SHTOJCA 1

KOMENTE MBI PROJEKTLIGJIN PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

1. KOMENTE TË ASPEKTIT NOMOTEKNIK DHE KONZISTENCA E LIGJIT VETVETIU OSE ME LIGJE TË TJERA

- 1.1. Nevojitet një përmirësim nomoteknik i strukturës së Ligjit, sepse përmban seksione ose kapituj të titulluar si „Dispozita të përgjithshme“, që më tej përmbajnë nene të titulluar „Dispozita të përgjithshme“.
- 1.2. Për shkak të nevojës për qëndrueshmëri të Ligjit dhe harmonizimit të dispozitave të tij strukturore dhe thelbësore, ne propozojmë në Nenin 2 paragrafi 1 të specifikohet që ligji zbatohet gjithashtu edhe për ndihmën juridike për fëmijët në rrezik dhe viktimat e veprave penale.
- 1.3. Dispozita që thotë: “Ky ligj nuk zbatohet për çështjet juridike për të cilat ndihma juridike falas ofrohet nga ligje të veçanta” duhet të përcaktohet në përputhje me Ligjin për Procedurën Kontestimore (i cili është një ligj i veçantë) dhe i cili parashikon mundësinë që kryetari i gjykatës të caktojë një avokat (avokati) palës që ka kërkuar përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve të procedurës. Në këtë situatë, e drejta për ndihmë juridike falas të secilës palë në procedurën gjyqësore do të mohohet për shkak të ekzistencës së kësaj dispozite të LPK-së. Ne propozojmë një ndryshim të këtij formulimi dhe të thuhet: ndihma juridike falas nuk do t’i ofrohet një personi që tashmë ka siguruar NJF sipas një bazë tjetër ligjore.
- 1.4. Përkufizimet duhet të përsosen dhe t’i përshtaten thelbit të domethënies teorike të ndihmës juridike falas, si dhe thelbit të ligjit. Terminologjia duhet të bëjë dallimin ndërmjet ndihmës juridike paraprake dhe ndihmës juridike dytësore. Nëse përdoret termi “Ndhmë juridike dytësore”, në vend të “Paraprake” është e nevojshme të përdoret “Ndhma parësore juridike”. Sidoqoftë, nëse juridikisht përdoret terminologjia “Ndhma paraprake juridike”, atëherë ndihma dytësore do të jetë vetëm “Ndhma juridike”. Këshillat juridike nuk mund të jenë të përgjithshme. Këshillat e përgjithshme juridike për një problem specifik juridik në vetvete janë në kundërshtim me çështjen, dhe për këtë arsye - nuk ka asnjë mënyrë të përgjithshme për të zgjidhur një çështje individuale. Këshillat e përgjithshme ligjore janë këshilla të zbatueshme për të gjithë, për raste më të ngjashme të natyrës faktike dhe juri-

dike. Këshillat juridike janë gjithmonë specifike, individuale, për një situatë specifike faktike. Duhet të fshihet mbiemri “i përgjithshëm”. “Aplikanti për ndihmë juridike falas” është përcaktuar ngushtë dhe përjashton personat që kanë kërkuar ose marrë ndihmë juridike paraprake. Është e nevojshme të shtrihet përkufizimi tek personat që kërkojnë dhe marrin ndihmë paraprake ligjore. “Anëtarët e familjes” është një term shumë i gjerë dhe përfshin të afërmit me të cilët aplikanti mund të jetojë në të njëjtën adresë por të mos i ndajë shpenzimet e jetesës.

2. KOMENTE PËR NDIHMËN PARAPRAKE JURIDIKE

- 2.1. Projektligji përcakton se të drejtën për ndihmë paraprake juridike e kanë “... të gjithë personat fizikë me vendbanim ose venqëndrim ...” Një dispozitë e tillë e gjerë do të harxhojë në mënyrë të padrejtë burimet e Ministrisë së Drejtësisë për personat që kanë fonde për të ofruar këshilla juridike nga një avokat. Është e nevojshme të kufizohet ndihma paraprake juridike vetëm për njerëzit që janë të varfër dhe të marginalizuar. Nga ana tjetër, kjo dispozitë, edhe pse e vendosur gjerësisht, mund të përfshijë edhe shtresat me gjendje të mirë financiare në shoqëri, por me formulimin “... vendbanim ose qëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë” i përjashton ata nga e drejta për ndihmë paraprake juridike, të ashtuquajturit persona të paregjistruar që nuk kanë certifikatë lindjeje nga libri amë dhe për këtë arsye nuk kanë dokumente identifikimi personal ose vendbanim. Është e nevojshme të përfshihet një paragraf i ri në të cilin do të renditet kjo kategori personash.
- 2.2. Fusha e ndihmës paraprake ligjore është përsëri e kufizuar. Mungon ajo që qytetarët e varfër dhe analfabetë e kërkojnë më së shumti, ajo është anëtarësimi në institucione dhe përpilimi i parashtresave në procedurat e përcaktuara saktësisht administrative (mbrojtja sociale, sigurimi shëndetësor, legalizimi dhe privatizimi i tokës, ankesat nga Avokati i Popullit dhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi). Pa përfshirjen e këtyre formave dhe modaliteteve të ndihmës juridike për të varfërit, qasja në drejtësi nuk do të lehtësohet. Nga ana tjetër, përfshirja e këtyre formave të ndihmës paraprake juridike në ligj do të jepte kuptimin e nevojshëm të “paraprake”, sepse do t’u lejojë qytetarëve të marrin informacione për rendin juridik të një çështje ligjore, pastaj këshilla ligjore se si të zgjidhin problemin e tyre, ndihmë në përcaktimin e të gjitha rrethanave të çështjes dhe në përpilimin e thjeshtë të shkresave në procedurën administrative. Avokatët zakonisht nuk janë të

nevojshëm për kryerjen e procedurave administrative, sepse sipas parimit të LPPA-së për ndihmë ndaj një pale të painformuar, vetë organet publike janë të detyruara të ndihmojnë palën për të realizuar të drejtën e tij. Kur ata nuk e kryejnë këtë detyrim, pala ka nevojë për këshilla juridike, ndihmë juridike parësore (plotësimi i një formulari, referimi i një sporteli specifik, nxjerrja në pah e një dispozite ligjore në favor të saj, marrja e një dokumenti nga një organ tjetër publik, etj.).

- 2.3. Përfshirja e një dispozite ligjore me diskrecion në përcaktimin e orëve të pritjes për personat është e panevojshme dhe e padrejtë, sepse qytetarët e varfër vetëm kur kanë ndonjë problem, atëherë drejtohen për ndihmë, dhe më shpesh jetojnë në zona periferike me transport të kufizuar. Prandaj, nuk është e drejtë të kthehen vetëm sepse nuk kanë ardhur në orarin e përcaktuar.
- 2.4. Ne besojmë se puna e shoqatave dhe zyrave rajonale duhet të dallohet qartë, të cilat nuk duhet të identifikohen sepse vetëm zyrat rajonale kanë detyrimin të shqyrtojnë gjendjen materiale dhe financiare të personit. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përfshihen forma të tjera të ndihmës paraprake juridike, veçanërisht këshillimi, informacioni, ndihma për klientët, çështja juridike e të cilëve mund të përfundojë pa ndihmë juridike dytësore dhe pa avokat.
- 2.5. Kompensimi i shoqatave për ndihmën e dhënë paraprake juridike - sipas projektligjit, shoqatës nuk do t'i paguhet kompensimi nëse përcaktohet se ndihma paraprake juridike nuk është dhënë në përputhje me këtë ligj, i cili konsideron vetëm informacionin dhe ndihmën në përbërjen dhe dorëzimin e kërkesa për ndihmë juridike dytësore. Ky vendim nuk e përmirëson pozicionin e shoqatave dhe nuk ndikon në motivimin e tyre për pjesëmarrje në sistemin shtetëror për ndihmë juridike falas, gjë që çon përsëri në një situatë të pazbatueshmërisë në praktikë. Shoqatat ofrojnë mbështetje paraprake përmes garantimit të shoqatave të autorizuara. Ky propozim u prezantua dhe shpjegua para përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë.

3. KOMENTE PËR NDIHMËN DYTËSORE JURIDIKE

- 3.1. Ndhima juridike e siguruar nga një avokat, e aprovuar në përputhje me këtë ligj, nuk duhet të kufizohet në përfaqësimin në gjykatë, organin shtetëror dhe lehtësimin nga shpenzimet. Është e nevojshme të përfshihet këshillimi dhe hartimi i shkresave, të cilat ne konsiderojmë se janë lënë pa dashje nga ky tekst. Mungon rregullimi i ndihmës dytësore juridike për përfaqësim në procedurat para një noteri, përmbaruesi dhe ndërmjetësuesi

- 3.2. Kundërthënia e një dispozite që thotë se "... gjykata në shpalljen e vendimit të gjykatës do të detyrojë palën kundërshtare të paguajë shumën e shpenzimeve të procedurës në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë", dhe ka një shënim në rregullimin e përmbajtjes së vendimit në procedurat gjyqësore që i nënshtrohet rregullimit të një ligji procedural sistematik - Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK). Për të kapërcyer këtë problem, ne propozojmë që detyrimi të lidhet me përfituesin e NJF-së.
- 3.3. Në vend që të kufizohet në mënyrë të padrejtë ndihma dytësore juridike ekskluzivisht për procedurat e trashëgimit të pasurisë në të cilën aplikanti jeton, është e nevojshme të garantohet NJF-ja për secilin person që plotëson kërkesat për NJF-së në të gjitha procedurat përpara një noteri për të cilin kërkohet përfaqësimi i detyrueshëm. Kjo vlen edhe për zbatimin, i cili kryhet në disa mënyra dhe të gjitha prekin ndjeshëm qytetarët e varfër, të cilët si debitorë kanë të drejtën e mbrojtjes ligjore. Ndodh shpesh që ekzekutimi të ketë mangësi ligjore që qytetarët nuk mund t'i adresojnë, sepse nuk kanë qasje në ndihmë juridike. Zbatimi i pasurive të patundshme fillon vetëm kur borxhi nuk mund të mblidhet përmes formave të tjera të ekzekutimit, prandaj është e palogjikshme që një formë të ketë ndihmë juridike dhe për një tjetër jo.
- 3.4. Pashtetësia si një fenomen për të cilin një numër në rritje i organeve shtetërore angazhohen ta çrrënjosin, me këtë ligj lihet jashtë rendit të ditës. Ka kohë që ka njohuri në vend për persona të tillë, të cilët për shkak të paqartësive administrative dhe procedurale, si dhe ligjore, dhe jo për fajin e tyre, nuk mund të rregullojnë qëndrimin e tyre në vend. Kjo nuk do të thotë që nëse ata nuk kanë një vendbanim të rregulluar ata duhet të përjashtohen nga e drejta për ndihmë juridike falas, dmth ndihmë dytësore juridike. Gjithashtu, shteti është e detyruar që t'ua ofrojë të gjithë mbrojtjen e mundshme këtyre personave që gjenden në rrezik social dhe shoqëror dhe të cilët gjeneratë pas gjenerate e bartin problemin e mungesës së shtetësisë dhe pamundësisë për të rregulluar qëndrimin. Nga njëra anë përfshirja e personave me nënshtetësi me qëndrim të rregulluar, kurse nga ana tjetër përjashtimi i personave pa nënshtetësi dhe pa qëndrim të rregulluar ligjor jep një pasqyrë të një dispozite pabarazie për të gjithë personat të cilëve vërtet u duhet ndihmë juridike falas. Duhet që në nenin që rregullon të drejtën e personave për të parashtruar kërkesë për ndihmë dytësore juridike të përmenden edhe personat e paregjistruar në librin amë, sepse pa ndihmë juridike nuk mund gjithmonë ta bëjnë regjistrimin dhe të përfitojnë dokumentet personale me vendbanim.
- 3.5. Kushtet kufizuese të pajustificueshme për të ardhurat mujore të kërkuesit që jeton në një familje të përbashkët me anëtarët e familjes së tij,

të ardhurat e të cilit për anëtar të familjes nuk duhet të kalojnë 20% të pagës minimale neto. Në këtë pjesë tashmë është ndërhyrë dy herë, ku fillimisht këto të ardhura ishin 50%, dhe pastaj u ulën në 20%. Kjo zgjidhje kufizon ndjeshëm aksesin në ndihmë juridike falas për të gjitha familjet me më shumë se një anëtar. Kjo zgjidhje është kundërthënëse në vetvete. Për shembull, një person i vetëm që fiton të ardhura mujore prej 12.000 denarë do të ketë të drejtën e NJF-së, një çift i martuar me të ardhura mujore prej 15.000 denarë, për 3.000 denarë më shumë, nuk do të ketë të drejtë në NJF.

- 3.6. Viktimat e dhunës në familje që përballen për herë të parë me dhunën në familje, viktimat që për arsye të ndryshme nuk e kanë raportuar deri më tani, si dhe viktimat që nuk janë regjistruar si viktimë nga qendrat për punë sociale nuk do të kenë të drejtën e ndihmës urgjente detyrore juridike. Këtu parashikohet prezantimi i “vërtetimit” se një person është viktimë e dhunës në familje. Si shoqata të deritanishme në çdo rast të mundshëm kemi theksuar jologjikitetin e kësaj gjendje. Viktimat e dhunës në familje nuk është status shoqëror ose juridik, prandaj duhet të provohet me konfirmim. Viktimat e dhunës në familje është një fakt që, për fat të keq, për shkak të pengesave të tilla dhe të ngjashme në rregulloret ekzistuese shpesh dëshmohet nga raportet mjekësore. Është joetike dhe fyese të vendosësh një kusht që viktimat e dhunës në familje, përveç gjithë problemeve të njohura me të cilat përballen, të inkurajohet të kërkojnë ndihmë juridike detyrore, të kërkojnë nga vetja të sjellë një certifikatë të tillë sikur të kishte një regjistër ose katalog të viktimat. Procedura për të cilën ofrohet kjo lloj ndihme juridike emergjente i referohet ekskluzivisht procedurave gjyqësore për vendosjen e masave të përkohshme dhe asgjë më shumë se kaq. Ne besojmë se për viktimat e dhunës në familje është e nevojshme të vendoset për miratimin e menjëherëshëm të BPP duke pasur parasysh provat që do të merren nga aplikanti, të cilat mund të jenë: vërtetim nga një shoqatë e standardizuar për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës në familje, si dhe nga ofruesit e tjerë të standardizuar të shërbimeve për viktimat (strehë/strehim, linjë SOS, këshillim psikosocial, qendra krize, etj., në frymën e Konventës së Stambollit, e cila kërkon bashkëpunim të organeve shtetërore me organizatat e shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes dhe një qasje të ndryshme, të integruar në ofrimin e shërbimeve nga të gjitha autoritetet), konfirmim i mëtejshëm i raportimit të një ngjarje ose procesverbali nga Ministria e Punëve të Brendshme, shënime mjekësore dhe certifikata mjekësore, gjykime të mëparshme dhe të ngjashme. Në praktikë, ka raste kur Qendra për punë sociale refuzon të regjistrojë viktimën, dhe në procedurat gjyqësore dhe me një vendim, të cilin viktimat e fillon vetë, statusi i tij dëshmohet, në këtë

mënyrë viktimat nuk do të jenë në gjendje të marrin vërtetimin e nevojshëm.

3.7. Nevojë për të rishikuar arsyet e refuzimit të ndihmës juridike, e cila është veçanërisht e diskutueshme dhe që ndikon vetëdijshtëm në ngushtimin e ndihmës juridike që mund të aprovohet sipas këtij ligji. E drejta për të kërkuar kompensim për dëmin jo-material është e nevojshme për kthimin e të drejtave të shkelura personale. Një zgjidhje e tillë do t'i lë pa të drejtën e ndihmës juridike falas qytetarët e varfër që kanë përjetuar dhimbje fizike, dhimbje shpirtërore, frikë, si dhe shkelje të të drejtave të tyre personale (për shembull me diskriminimin). Në afat të gjatë, mosngritja e proceseve gjyqësore mund të sjellë ndjenjën e „pandëshkueshmërisë“ dhe „papërgjegjësisë“ të autorët e këtij lloji dëmi dhe rritjen e veprimeve të tilla. Për shkak të kësaj, duhet të mundësohet qasje në ndihmën dytësore juridike sa i përket kompensimit për dëm jomaterial, si dhe për lëndët që kanë të bëjnë me veprimtaritë komunale dhe publike.

3.8. Nuk është parashikuar asnjëmjjet juridik, pavarësisht urgjencës së

procedurës dhe kërkesës së paraqitur në kohë, zyra rajonale nuk vepron në përputhje me ligjin. Përndryshe, nuk mund të garantohet që zyrat rajonale do të veprojnë në përputhje me këtë dispozitë, dmth përkundër urgjencës së procedurës, atyre u është dhënë mundësia që t'ia përcjellin kërkesën Ministrisë së Drejtësisë në një procedurë të rregullt.

3.9. Mungon dispozita për parashkrimin e kërkesave. Në fakt, në Ligj duhet të shtohet „...por jo pas skadimit të tre viteve nga dita e marrjes së veprimit të fundit në kuadër të ndihmës dytësore juridike nga ana e avokatit“.

3.10. Të harmonizohet me terminologjinë e përdorur në Ligjin për Procedurën Kontestimore. Për këtë ne kemi paraqitur një propozim në Ministri se si duhet të rregullohet në mënyrë që të gjitha rastet ku NJF-ja aprovohet në procedura kontestimore dhe të cilat kanë përfunduar me sukses të rezultojnë me kthimin e fondeve të dhëna në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

4. KOMENTE PËR PROCEDURAT E VEÇANTA

4.1. Mbrojtja dhe përfaqësimi në procedurat penale sigurohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale (LPP). Viktimat e procedurave penale që paraqiten si të dëmtuar lihen pa të drejtën e ndihmës juridike falas në LNJF, dhe një e drejtë e tillë nuk parashikohet as në LPP.

4.2. Ndhimë juridike për fëmijë—i gjithë koncepti i ndihmës juridike për fëmijët në rrezik dhe fëmijët-autorë të veprave penale është jashtëzakonisht

problematic. Në procedurat para Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Qendrës për Punë Sociale (QPS), ndihma juridike falas sigurohet dhe paguhet në përputhje me këtë ligj, dhe për veprimet para gjykatës dhe prokurorisë emërohen avokatë të tjerë caktohen dhe paguhen nga buxheti i gjykatës. Përveç pagesës së vonuar të këtyre kostove, lindin situata kur fëmija, për të njëjtën procedurë, para organeve të ndryshme mund të kenë avokatë të ndryshëm. Ka nevojë për një reformë gjithëpërfshirëse të modelit për ndihmën juridike të fëmijëve.

- 4.3. Ndhma juridike për azilkërkuesit - ligji parashikon “Çdo tre muaj Ministria azhurnon listën e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike në procedurën e njohjes së të drejtës së azilit dhe ia paraqet atë institucionit përgjegjës për të vendosur mbi kërkesat e azilit”. Kjo dispozitë duhet të fshihet nga ligji, pasi nuk ka mundësi që një avokat të specializohet në fushën e azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare, ashtu si nuk ka specializim të asnjë avokati për ndonjë procedurë procesuese. Prandaj lind pyetja se si dhe mbi çfarë baze do të drejtojë këtë listë të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike në procedurën e azilit.
5. Përveç ditëve për këshilla juridike falas, duhet të shtohen dispozitat për fuqizimin ligjor dhe edukimin e qytetarëve. Ditët e këshillimit ligjor falas rregullohen si një formalitet që ndodh dy herë në vit dhe në të cilin marrin pjesë jo më shumë se 10 deri në 15 qytetarë. Ministria e Drejtësisë, përveç raportit vjetor, duhet të ketë edhe një program vjetor dhe financiar, në të cilin do të parashikojë trajnime, kolegjiime dhe koordinim, mbikëqyrje etj. Pikërisht në këtë program të Ministrisë në detaje duhet të parashikohen dhe rregullohen aktivitetet me të cilët do të bëhet fuqizimi ligjor dhe edukimi i grupeve të caktuara të marginalizuara. Për shembull, të aprovohen fonde për trajnime për të drejtat e punëtorëve; programe për parajuristë që ju ndihmojnë grupeve specifike, siç janë: romët, personat me nevoja të veçanta, të rinjtë e papunë, viktimat e dhunës në familje dhe të ngjashme.
6. Kudo në tekstin e projektligjit, ku përdoret termi „dhunë me bazë gjinore“ të shtohet edhe termi „dhunë në familje“ dhe anasjelltas, në nenet ku përdoret termi „dhunë në familje“ të shtohet edhe termi „dhunë me bazë gjinore“.



KOMITETI I
 **HELSINKIT** 
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKES SË
MAQEDONSË